



Demokracia në Veprim
Demokratija na Delu
Democracy in Action

RAPORTI I VËZHGIMIT TË ZGJEDHJEVE PËR KUVENDIN E KOSOVËS

INTEGRITETI
ZGJEDHOR 2025

28 DHJETOR, 2025



RAPORTI I VËZHGIMIT TË ZGJEDHJEVE PËR KUVENDIN E KOSOVËS

DEMOKRACIA NË VEPRIM

28 DHJETOR, 2025

Misioni vendor i Demokracisë në Veprim (DnV) për vëzhgimin e zgjedhjeve është mbështetur nga Ambasada e Zvicrës, si dhe Ambasada Suedeze në Kosovë. Opinionet, gjetjet dhe rekomandimet e shprehura në këtë raport janë përgjegjësi e Demokracisë në Veprim dhe jo domosdoshmërisht paraqesin pikëpamjet e donatorit.

Demokracia në Veprim
Rruga “Bajram Kelmendi” nr. 239
10 000 Prishtinë, Kosovë
Tel: +383 (0) 38 248 038

Përmbajtja

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	6
1. MISIONI DHE METODOLOGJIA E DNV-SË	9
2. KONTEKSTI POLITIK	10
3. KORNIZA LIGJORE	11
4. ADMINISTRIMI I ZGJEDHJEVE	13
4.1. Puna e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve	13
4.2. Komisionet Komunale Zgjedhore dhe Këshillat e Vendvotimeve	15
4.3. Puna në Qendrat Komunale të Numërimit	15
4.4. Puna në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve	16
4.5. Certifikimi i subjekteve politike dhe kandidatëve të tyre	17
4.6. Certifikimi i listës së votuesve dhe Shërbimi i Votuesve	17
4.7. Votimi jashtë vendit	24
5. FUSHATA ZGJEDHORE	25
6. VËZHGIMI I ZGJEDHJEVE	26
7. DITA E ZGJEDHJEVE	27
8. REZULTATET DHE PROCESI PASZGJEDHOR	29
9. DREJTËSIA ZGJEDHORE	38
REKOMANDIMET	44
I. Reforma strukturore e sistemit zgjedhor	44
II. Korniza e përgjithshme ligjore dhe modeli institucional	45
III. Integriteti dhe administrimi zgjedhor	45
Lista e Votuesve:	46
Votimi jashtë vendit:	46
IV. Fushata zgjedhore	47
Financimi i subjekteve politike gjatë fushatës	47
V. Përfaqësimi gjinor	48
VI. Drejtësia zgjedhore	48
Shtojca 1: Rezultatet e certifikuara të zgjedhjeve dhe ndarja e ulëseve sipas subjekteve politike	49

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Koalicioni i organizatave vendore për vëzhgimin e zgjedhjeve, Demokracia në Veprim (DnV), vlerëson se zgjedhjet e parakohshme parlamentare të 28 dhjetorit 2025 janë zhvilluar përgjithësisht në përputhje me standardet demokratike për zgjedhje të lira dhe konkurruese. Megjithatë, faza paszgjedhore rezultoi me mangësi serioze në raport me administrimin e votave preferenciale të kandidatëve.

Vendimi për rinumërim të plotë në nivel vendi, pas evidentimit të devijimeve masive në numërimin e votave të kandidatëve, përbën zhvillimin më domethënës të këtij procesi zgjedhor. Megjithëse rinumërimi riktheu integritetin teknik të rezultatit përfundimtar dhe nuk prodhoi ndryshime thelbësore në shpërndarjen e mandateve ndërmjet subjekteve politike, përmasa e korrigjimeve – me mbi 240 mijë vota preferenciale gjithsej – ndikoi ndjeshëm në perceptimin publik për besueshmërinë e administrimit zgjedhor. Transparenca e procesit të rinumërimit në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve, përfshirë transmetimin e drejtpërdrejtë dhe publikimin e detajuar të të dhënave, kontribuoi në stabilizimin e situatës dhe në konsolidimin e rezultateve përfundimtare. Në këtë drejtim, procesi u karakterizua nga një periudhë e zgjatur, e cila zgjati 34 ditë nga dita e zgjedhjeve deri në shpalljen e rezultateve përfundimtare, ndërsa gjithsej 44 ditë deri në certifikimin e tyre nga KQZ-ja.

Administrimi i përgjithshëm i procesit zgjedhor ishte në thelb i qëndrueshëm dhe përgjithësisht pozitiv, ndonëse i shoqëruar me disa sfida të natyrës institucionale, procedurale dhe politike, të cilat në disa raste ndikuan në cilësinë e administrimit dhe në perceptimin publik të procesit.

Procesi i votimit gjatë Ditës së Zgjedhjeve është zhvilluar kryesisht në një atmosferë të qetë dhe demokratike, pa incidente serioze të sigurisë që do të mund të cenonin integritetin e zgjedhjeve. Dalja e votuesve ka qenë relativisht e lartë, ndërsa shumica e parregullsive të evidentuara nga vëzhguesit e DnV-së kanë qenë të

karakterit procedural dhe nuk kanë ndikuar në rezultatin e përgjithshëm të procesit zgjedhor.

Identifikimi i votuesve u zhvillua kryesisht në përputhje me rregullat, ndërsa votimi me asistencë shënoi ulje të ndjeshme krahasuar me ciklet e mëparshme. Rastet e cenimit të fshehtësisë së votës dhe fotografimit të fletëvotimeve mbetën të izoluara. Publikimi i shpejtë i rezultateve preliminare nga KQZ dhe pranimi i tyre nga subjektet kryesore kontribuan në ruajtjen e stabilitetit paszgjedhor.

Performanca e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve gjatë këtyre zgjedhjeve paraqet një kontrast administrimit të rregullt në fazën përgatitore dhe sfidave serioze në fazën paszgjedhore. Në periudhën parazgjedhore dhe në Ditën e Zgjedhjeve, KQZ – në mbështetje të Sekretariatit – siguroi një nivel të kënaqshëm transparence dhe raportim publik, përfshirë publikimin e rezultateve preliminare.

Procesi vendimmarrës ishte kryesisht konsensual në çështjet teknike, ndonëse temat e ndjeshme, si votimi jashtë vendit, certifikimi dhe përbërja e trupave zgjedhore, u shoqëruan me përplasje politike që shpesh e tejkaluan natyrën administrative të vendimmarrjes. Faza paszgjedhore shënoi pikën më kritike, pas evidentimit të devijimeve masive në numërimin e votave preferenciale të kandidatëve, të cilat çuan në rinumërim të plotë në nivel vendi dhe ekspozuan dobësi në organizimin, trajnimin dhe mbikëqyrjen e procesit të numërimit. Transparenca e rinumërimit në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve – përfshirë transmetimin dhe publikimin e të dhënave – kontribuoi në stabilizimin e situatës dhe në konsolidimin e rezultateve, të cilat u formalizuan përmes certifikimit unanim nga KQZ më 9 shkurt 2026, pas shqyrtimit të ankesave në PZAP dhe në Gjykatën Supreme.”

Procesi i certifikimit të subjekteve politike u shoqërua sërish me vendime të kundërligjshme nga KQZ. Refuzimi fillestar për certifikimin e Listës Serbe, pavarësisht përmbushjes së kriterëve ligjore, u korrigjua vetëm pas ndërhyrjes së Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashpresa (PZAP) dhe Gjykatës Supreme. Ky rast dëshmoi ndikimin e konsideratave politike mbi vendimmarrjen administrative dhe cenoi besimin në pavarësinë institucionale të KQZ-së.

Fushata zgjedhore është zhvilluar në një ambient të qetë dhe pa incidente serioze të sigurisë, por është karakterizuar me entuziazëm të zbehtë por është karakterizuar me entuziazëm të zbehtë dhe me pjesëmarrje që ka luhatur ndjeshëm mes subjekteve politike dhe formave të organizuara të aktiviteteve, me fokus kryesisht në qendrat urbane dhe në ambiente të mbyllura. Fushata ka qenë dukshëm e personalizuar dhe e centralizuar rreth liderëve partiakë, duke reduktuar hapësirën për ekspozim dhe artikulum individual të kandidatëve për deputetë.

Megjithatë, barazia e garës zgjedhore u cenua nga përdorimi i resurseve publike për qëllime elektorale. Vendimi i Qeverisë për ndarjen e përfitimeve financiare për kategori të caktuara qytetarësh vetëm pak ditë para zgjedhjeve krijoi perceptimin e ndërhyrjes së pushtetit ekzekutiv në ambientin elektoral. Edhe pse masa të tilla mund të kenë bazë sociale apo të jenë precedentë nga vitet paraprake, koha e miratimit dhe mënyra e komunikimit publik kanë cenuar parimin e barazisë së garës dhe kanë sfiduar ndarjen ndërmjet funksionit shtetëror dhe interesit partiak.

Përfaqësimi gjinor gjatë fushatës dhe në listat zgjedhore ka mbetur kryesisht formal. Gratë kanë qenë të nënpërfaqësuar si folëse në aktivitetet e fushatës dhe asnjë nga subjektet politike nuk ka shkuar përtej minimumit ligjor prej 30-35% përfaqësim të grave në listat zgjedhore, duke reflektuar mungesë të vullnetit politik për fuqizim real të grave në politikë.

Diskursi politik gjatë fushatës zgjedhore ka qenë përgjithësisht më i moderuar krahasuar me proceset e kaluara zgjedhore. PZAP ka trajtuar një numër relativisht të kufizuar ankesash dhe nuk është evidentuar asnjë rast i sanksionuar për përdorim të gjuhës nxitëse apo të urrejtjes. Megjithatë, janë shqiptuar gjopa të konsiderueshme për shkelje të rregullave të fushatës, veçanërisht për vendosje të materialeve zgjedhore në hapësira publike dhe përdorim të burimeve publike për qëllime elektorale.

Votimi jashtë vendit ka qenë një nga segmentet e ndjeshme të këtyre zgjedhjeve. Interesimi i votuesve jashtë Kosovës ka qenë i lartë, veçanërisht në votimin në ambasada, ku është shënuar një dalje mbi 84%. Megjithatë, procesi i votimit me postë është shoqëruar me sfida logjistike dhe shqetësime mbi sigurinë dhe mbikëqyrjen institucionale.

Lista e votuesve vazhdon të mbetet një çështje problematike strukturore. Edhe pse KQZ ka ndër marrë hapa për pastrimin dhe verifikimin e saj, numri i përgjithshëm i votuesve të regjistruar mbetet dukshëm më i lartë se popullsia rezidente e Kosovës, duke cenuar besimin e publikut në saktësinë e listës zgjedhore.

Institucionet përgjegjëse për drejtësinë zgjedhore, respektivisht Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashpresa dhe Gjykata Supreme, vepruan me profesionalizëm dhe në përputhje me afatet ligjore në trajtimin e kontesteve zgjedhore. Drejtësia zgjedhore u karakterizua nga një volum relativisht i kufizuar ankesash dhe nga mungesa e kontesteve që do të rrezikonin stabilitetin institucional të procesit. Vendimet e këtyre institucioneve kontribuan në ruajtjen e integritetit procedural dhe në korrigjimin e vendimeve administrative të kontestuara, duke garantuar mbrojtjen e të drejtave zgjedhore dhe zbatimin e barabartë të rregullave.

Zgjedhjet janë monitoruar nga një numër i madh vëzhguesish. Në total, mbi 19,000 vëzhgues janë akredituar nga KQZ, ku pjesa dërrmuese i përkiste subjekteve politike. Prania e gjerë e vëzhguesve ka kontribuar në transparencën e procesit, veçanërisht në Ditën e Zgjedhjeve, ndërsa në fazat e mëvonshme – sidomos gjatë numërimit të votave për kandidatët nëpër Qendrat Komunale të Numërimit – prania dhe mbulimi i procesit nga vëzhguesit ka qenë më i kufizuar, e në disa raste fare minimal. Roli i vëzhgimit të pavarur vendor mbetet thelbësor për vlerësimin objektiv të procesit zgjedhor.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka shënuar progres në raport me informimin publik, përmes zhvillimit të fushatave gjithëpërfshirëse të informimit dhe edukimit të votuesve, duke ofruar materiale të detajuara për pothuajse të gjitha fazat dhe operacionet zgjedhore. Përdorimi më intensiv i rrjeteve sociale dhe platformave digjitale ka rritur dukshmërinë dhe qasjen në informacion për qytetarët, duke reflektuar përmirësim të dukshëm krahasuar me ciklet e mëparshme. Megjithatë, zhvillimi i mëtejshëm i formateve kreative dhe të përshtatura me trendet bashkëkohore të komunikimit digjital do të mund të forconte edhe më shumë ndërveprimin dhe efektivitetin e këtyre fushatave.

1. MISIONI DHE METODOLOGJIA E DNV-SË

Demokracia në Veprim (DnV) është koalicion i organizatave të shoqërisë civile që promovon zgjedhje të lira dhe të drejta në Kosovë përmes vëzhgimit sistematik të proceseve zgjedhore, edukimit të votuesve dhe avokimit për reforma zgjedhore.

Në zgjedhjet e parakohshme parlamentare të 28 dhjetorit 2025, DnV ka zbatuar një mision vëzhgimi me qëllim ofrimin e një vlerësimi të pavarur, profesional dhe gjithëpërfshirës të procesit zgjedhor, me fokus tek dita e zgjedhjeve dhe perioda e trajtimit të ankesave zgjedhore.

Misioni i vëzhgimit është mbështetur në angazhimin e rreth 700 vullnetarëve të trajnuar. Vëzhgimi ka përfshirë periudhën përgatitore të zgjedhjeve, zhvillimet gjatë fushatës zgjedhore, ditën e votimit dhe fazën paszgjedhore – të kufizuar kryesisht tek puna në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR) duke synuar dokumentimin e rregullsisë së procedurave dhe funksionimit të institucioneve zgjedhore në tërësi.

DnV ka ndjekur zhvillimin e fushatës zgjedhore përmes monitorimit analitik të aktiviteteve publike, diskursit politik dhe praktikave të subjekteve politike, me qëllim identifikimin e trendeve kryesore dhe çështjeve që ndikojnë në cilësinë e garës zgjedhore. Paralelisht, misioni ka monitoruar në vazhdimësi mbledhjet e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), si pjesë e vëzhgimit të administrimit zgjedhor.

Në ditën e zgjedhjeve, mbi 600 vullnetarë janë angazhuar në terren. Prej tyre, 500 vëzhgues janë vendosur në vendvotime sipas metodologjisë së numërimit paralel të votave (Parallel Vote Tabulation – PVT), një metodologji e njohur ndërkombëtarisht dhe e bazuar në mostër statistikisht të provuar. Kjo qasje i ka mundësuar DnV-së të sigurojë të dhëna të besueshme mbi zhvillimin e votimit dhe vet rezultatet preliminare.

Rreth 50 vëzhgues të angazhuar si ekipe mobile kanë përcjellë atmosferën e përgjithshme në qendrat e votimit dhe përreth tyre, ndërsa rreth 50 vullnetarë të tjerë kanë operuar në Qendrën e të Dhënave, përmes së cilës janë mbledhur, procesuar dhe analizuar në kohë reale raportimet nga terreni.

Pas ditës së zgjedhjeve, DnV ka vazhduar vëzhgimin, ndonëse me përfshirje dhe kapacitete të kufizuar. DnV ka ndjekur dhe analizuar punën e Qendrës së Numërimit dhe Rezultateve (QNR), si përmes pranisë fizike në disa raste, ashtu edhe përmes analizimit në distancë të të dhënave dhe njoftimeve zyrtare. Njëkohësisht, ekipi ligjor i DnV-së ka përcjellë procesin e drejtësisë zgjedhore, duke monitoruar trajtimin e ankesave në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP) dhe në Gjykatën Supreme.

Të gjeturat e detajuara nga vëzhgimi para, gjatë dhe pas ditës së zgjedhjeve paraqiten në këtë raport përfundimtar, i cili synon të ofrojë një analizë të plotë të procesit zgjedhor dhe të kontribuojë në përmirësimin e tij në të ardhmen. Metodologjia e aplikuar nga DnV respekton standardet ndërkombëtare për vëzhgimin e zgjedhjeve demokratike dhe parimet e paanshmërisë, transparencës dhe profesionalizmit.

2. KONTEKSTI POLITIK

Zgjedhjet e parakohshme parlamentare të 28 dhjetorit 2025 u mbajtën në një kontekst të një krize të thellë politike dhe institucionale, e cila pasoi zgjedhjet e rregullta parlamentare të 9 shkurtit 2025. Për afro dhjetë muaj pas këtyre zgjedhjeve, Kosova mbeti pa formimin e një qeverie të re, për shkak të fragmentimit të përbërjes parlamentare dhe pamundësisë së subjekteve politike për të siguruar shumicën e nevojshme për konstituimin e institucioneve.

Rezultati i zgjedhjeve të shkurtit prodhoi një Kuvend të fragmentuar, ku asnjë subjekt politik nuk arriti të sigurojë 61 votat e nevojshme për formimin e qeverisë. Përpjekjet për ndërtimin e një koalicioni qeverisës dështuan në mënyrë të përsëritur, ndërsa mungesa e konsensusit për zgjedhjen e Kryetarit të Kuvendit – si parakusht kushtetues për formimin e ekzekutivit – e zgjati bllokadën institucionale për muaj të tërë. Edhe ndërhyrjet e Gjykatës Kushtetuese nuk arritën të prodhonin një zgjidhje funksionale të qëndrueshme, duke e lënë vendin në një gjendje të vazhdueshme paqartësie institucionale.

Kjo situatë ndikoi drejtpërdrejt në përkeqësimin e klimës politike dhe në rritjen e polarizimit ndërmjet subjekteve kryesore politike. Diskursi publik u karakterizua nga akuza të ndërsjella për përgjegjësinë e bllokadës, ndërsa komunikimi institucional mes aktorëve politikë u reduktua ndjeshëm. Kjo dinamikë kontribuoi në rënien e besimit të qytetarëve në institucionet përfaqësuese dhe në procesin politik në përgjithësi.

Bllokada institucionale pati pasoja konkrete në funksionimin e shtetit. Aktiviteti legjislativ mbeti pothuajse i paralizuar, miratimi i buxhetit u vonua, ndërsa një numër marrëveshesh ndërkombëtare me rëndësi financiare dhe zhvillimore mbetën të paratifikuara. Pamundësia për të marrë vendime strategjike ndikoi në aftësinë e Kosovës për të përfituar nga mekanizmat e mbështetjes së partnerëve ndërkombëtarë dhe për të përmbushur obligimet e saj në raport me proceset integruese.

Në planin ndërkombëtar, kriza e brendshme institucionale përkoi me rritjen e presionit diplomatik për avancimin e dialogut me Serbinë dhe zbatimin e marrëveshjeve të arritura në kuadër të ndërmjetësimit evropian. Mungesa e një qeverie me mandat të plotë kufizoi kapacitetin negociues të institucioneve dhe e rriti perceptimin e paqëndrueshmërisë politike të vendit në arenën ndërkombëtare.

Në këtë kontekst, zgjedhjet e 28 dhjetorit u perceptuan gjerësisht si një moment vendimtar për rikthimin e funksionalitetit institucional dhe stabilitetit politik. Pritjet publike dhe ndërkombëtare nga ky proces zgjedhor ishin të larta, ndërsa integriteti dhe kredibiliteti i tij u konsideruan thelbësorë për rivendosjen e besimit në sistemin demokratik.

Zgjedhjet e shkurtit të vitit 2025, ndonëse përgjithësisht të qeta dhe të administruara pa incidente serioze sigurie, kishin evidentuar një sërë dobësish strukturore në administrimin zgjedhor dhe në menaxhimin e proceseve paszgjedhore. Këto çështje mbetën kryesisht të paadresuara në periudhën ndërmjet dy proceseve zgjedhore, duke e rritur rëndësinë e vëzhgimit të pavarur vendor. Duke pasur parasysh se prania e misioneve ndërkombëtare të vëzhgimit ishte minimale, roli i vëzhgimit vendor të organizuar u bë edhe më i rëndësishëm për garantimin e transparencës, llogaridhënies dhe besimit publik në procesin zgjedhor.

3. KORNIZA LIGJORE

Korniza ligjore që rregullon zgjedhjet parlamentare në Kosovë mbështetet në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme, Ligjin për Financimin e Subjekteve Politike, Kodin Penal dhe aktet nënligjore të miratuara nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ). Ky kuadër normativ synon të garantojë administrimin e zgjedhjeve në përputhje me standardet demokratike, transparencën e procesit dhe integritetin e përfaqësimit politik.

Zgjedhjet e parakohshme parlamentare të 28 dhjetorit 2025 u zhvilluan mbi bazën e Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, të miratuar në qershor 2023, si dhe të ndryshimeve të mëparshme në Ligjin për Financimin e Subjekteve Politike të vitit 2022. Këto zgjedhje përfaqësuan testin e dytë praktik të “reformës zgjedhore” të vitit 2023 dhe konfirmuan se shumica e sfidave të evidentuara në procesin zgjedhor të shkurtit 2025 vazhduan të jenë të pranishme edhe në zgjedhjet e dhjetorit.

Sistemi zgjedhor në Kosovë mbetet proporcional me lista të hapura, ku i gjithë territori përbën një zonë të vetme zgjedhore për 120 ulëset në Kuvend. Nga këto, 20 ulëse janë të garantuara për komunitetet joshumicë – 10 për komunitetin serb dhe 10 për komunitetet e tjera. Për subjektet politike që garojnë për 100 ulëset e përgjithshme zbatohet pragu zgjedhor prej 5%, ndërsa ky prag nuk aplikohet për subjektet që garojnë për ulëset e garantuara.

Pavarësisht pritshmërive për një reformë më gjithëpërfshirëse zgjedhore, ndryshimet e vitit 2023 u përqendruan kryesisht në riorganizim teknik dhe administrativ të proceseve, duke lënë të paadresuara një sërë çështjesh strukturore që lidhen me integritetin e zgjedhjeve. Për më tepër, disa nga këto ndryshime kanë prodhuar pasoja të drejtpërdrejta në praktikë, duke ndikuar në efikasitetin, transparencën dhe besueshmërinë e procesit zgjedhor.

Ndër ndryshimet më të rëndësishme ishte zgjerimi i opsioneve të votimit jashtë vendit, përmes mundësisht të votimit fizik në misionet diplomatike dhe votimit me postë përmes kutive postare të tyre. Kjo risi synonte rritjen e pjesëmarrjes së diasporës dhe zvogëlimin e rreziqeve të manipulimit në votimin postar. Megjithatë, zbatimi praktik i këtij modeli në dy procese zgjedhore brenda të njëjtit vit tregoi se infrastruktura ligjore dhe administrative mbetet e mangët për të garantuar një proces plotësisht të standardizuar dhe të mbikëqyrtur në mënyrë të barabartë.

Një ndryshim tjetër me ndikim të drejtpërdrejtë në administrimin e zgjedhjeve ishte rikthimi i votimit preferencial deri në 10 kandidatë. Edhe pse qëllimi i këtij ndryshimi ishte zgjerimi i zgjedhjes së votuesit, në praktikë ai ka prodhuar rritje të ndjeshme të kompleksitetit të procesit të numërimit. Për më tepër, transferimi i numërimit të votave preferenciale nga vendvotimet në Qendrat Komunale të Numërimit ka sjellë vonesa të konsiderueshme dhe ka reduktuar transparencën e menjëhershme të procesit. Zgjedhjet e vitit 2025 konfirmuan se ky model nuk ka prodhuar vlerë të shtuar në integritetin e procesit, ndërsa ka rritur ndjeshëm kohëzgjatjen e administrimit paszgjedhor.

Ndryshimi i mekanizmit për shkarkimin e kryesuesit dhe anëtarëve të KQZ-së përbën një tjetër element me ndikim institucional. Mundësia që shkarkimi të iniciohet nga 2/3 e anëtarëve të KQZ-së, synonte rritjen e llogaridhënies, por në praktikë ka rritur perceptimin për politizim të brendshëm të institucionit, e mbase edhe pamundësim të inicimit të procedurave të shkarkimit, në mungesë të këtyre votave. Në një ambient politik të polarizuar, ky mekanizëm krijon rrezik potencial për presion politik mbi administratën zgjedhore.

Sa i përket financimit të subjekteve politike, ndryshimet e vitit 2022 kanë forcuar kornizën e raportimit financiar dhe transparencës. Megjithatë, monitorimi efektiv i shpenzimeve gjatë fushatës, veçanërisht në hapësirën digjitale dhe në rrjetet sociale, mbetet sfidë e pazgjidhur. Korniza ekzistuese nuk ofron mekanizma të mjaftueshëm për kontroll në kohë reale të shpenzimeve, duke krijuar hapësira për shmangie të raportimit.

Në aspektin e barazisë gjinore, vazhdon të zbatohet kuota ligjore prej 30% për gjininë më pak të përfaqësuar në listat zgjedhore dhe në ndarjen e ulëseve. Edhe pse ky mekanizëm garanton një minimum përfaqësimi, zgjedhjet e vitit 2025 treguan se ai mbetet kryesisht formal dhe nuk ka prodhuar progres substancial drejt barazisë reale në përfaqësim politik.

Në përgjithësi, përvoja e dy proceseve zgjedhore brenda vitit 2025 konfirmoi se ndryshimet në legjislacionin zgjedhor, të vitit 2023, nuk kanë adresuar mangësitë themelore të sistemit. Përkundrazi, disa nga ndryshimet e miratuara kanë krijuar sfida të reja operative dhe institucionale. Shumica e problemeve të evidentuara në administrimin zgjedhor, numërimin e votave dhe procesin paszgjedhor lidhen drejtpërdrejt me dizajnin e ndryshimeve të fundit, duke theksuar nevojën për një rishikim më të thellë dhe gjithëpërfshirës të kornizës ligjore zgjedhore.

4. ADMINISTRIMI I ZGJEDHJEVE

Bazuar në dispozitat kushtetuese dhe ligjore në fuqi, organi përgjegjës për përgatitjen, mbikëqyrjen, drejtimin dhe verifikimin e të gjitha veprimeve që lidhen me procesin zgjedhor, si dhe për shpalljen e rezultateve, është Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ). Në ushtrimin e kompetencave të tij, KQZ mbështetet nga Sekretariati i KQZ-së, si strukturë profesionale dhe administrative përgjegjëse për zbatimin teknik të vendimeve.

Në nivel lokal, administrimi i zgjedhjeve realizohet përmes Komisioneve Komunale Zgjedhore (KKZ), të themeluara në secilën nga 38 komunat e Kosovës, ndërsa në ditën e zgjedhjeve procesi menaxhohet nga Këshillat e Vendvotimeve, të përbëra nga pesë deri në shtatë anëtarë.

Qendrat Komunale të Numërimit (QKN) shërbejnë si lokacione për pranimin e materialit zgjedhor, verifikimin e votave të subjekteve politike dhe numërimin e votave të kandidatëve. Ato funksionojnë gjithashtu si hapësira për trajnimin e trupave menaxhuese zgjedhore. Pas përfundimit të ditës së zgjedhjeve, procesi i numërimit të votave me kusht, votave nga jashtë vendit dhe çdo rinumërimi eventual zhvillohet në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR), në përputhje me vendimet e KQZ-së.

Administrimi i zgjedhjeve të parakohshme të 28 dhjetorit 2025 u zhvillua në një kontekst të ngarkuar politik dhe brenda afateve të ngushta kohore, çka ndikoi drejtpërdrejt në ritmin dhe cilësinë e përgatitjeve teknike dhe organizative. Përkundër këtyre kufizimeve, administrata zgjedhore arriti të realizojë shumicën e operacioneve të planifikuara, ndonëse me sfida të dukshme në koordinim institucional, menaxhim të kohës dhe komunikim publik.

4.1. Puna e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve mbetet institucioni kushtetues përgjegjës për organizimin, drejtimin dhe verifikimin e të gjitha operacioneve zgjedhore në Republikën e Kosovës. Zgjedhjet e parakohshme parlamentare të 28 dhjetorit 2025 u zhvilluan në një kontekst institucional të ndërlikuar dhe me kalendar të përshpejtuar, çka e vendosi administratën zgjedhore përballë një presioni të jashtëzakonshëm organizativ. Në këtë kuadër, performanca e KQZ-së paraqet një kombinim të elementeve pozitive në fazën përgatitore dhe sfidave serioze në fazën paszgjedhore.

Që nga shpallja e datës së zgjedhjeve, KQZ zhvilloi rreth 30 mbledhje publike, gjatë të cilave miratoi vendime kyçe për administrimin e procesit. Mbledhjet ishin përgjithësisht të hapura për publikun, duke mundësuar monitorim të vazhdueshëm nga shoqëria civile dhe mediat. Në fazën përgatitore dhe gjatë ditës së zgjedhjeve, puna e Sekretariatit të KQZ-së u karakterizua nga një nivel i kënaqshëm profesionalizmi. Publikimi i rezultateve preliminare, raportimi në kohë reale dhe qasja proaktive në publikim të të dhënave, u menaxhuan në mënyrë transparente.

Procesi vendimmarrës ishte kryesisht konsensual, sidomos në çështjet teknike. Megjithatë, disa tema të ndjeshme prodhuan përplasje politike të theksuara ndërmjet anëtarëve të Komisionit. Debatet rreth votimit jashtë vendit, certifikimit të subjekteve politike dhe përbërjes së trupave zgjedhore shpesh tejkaluan natyrën administrative dhe morën dimension tërësisht politik e partiak. Kjo reflektoi një tension të vazhdueshëm mes rolit politik të anëtarëve të KQZ-së dhe nevojës për administrim teknik të paanshëm të procesit zgjedhor.

Zgjedhjet e parakohshme u zhvilluan në një kalendar të ngjeshur kohor. Përkundër kësaj, KQZ arriti të emërojë mbi 11 mijë komisionerë dhe të realizojë trajnime të përsheptuara për trupat menaxhuese zgjedhore. Përdorimi i teknologjisë për raportim dhe menaxhim të të dhënave kontribuoi në standardizimin e disa proceseve teknike, megjithëse sfida operative mbetën të pranishme.

Një element që u evidentua gjatë gjithë procesit ishte përfshirja e drejtpërdrejtë e përbërjes politike të KQZ-së në vendimmarrje të natyrës teknike dhe administrative. Ndërhyrjet në çështje që normalisht i takojnë Sekretariatit krijuan ngarkesë shtesë institucionale dhe në disa raste ngadalësuan ritmin e operacioneve. Kjo përfshirje e funksionit politik në atë administrativ mbetet një dobësi strukturore e modelit aktual të administrimit zgjedhor.

Faza paszgjedhore shënoi pikën më kritike të procesit. Dyshimet për parregullsi në numërimin e votave preferenciale në Qendrat Komunale të Numërimit prodhuan krizë të theksuar besimi publik. Fillimisht, KQZ ndër-mori verifikimin e 2% të vendvotimeve pas analizimit të incizimeve të kamerave dhe evidentimit të mospër-puthjeve serioze në disa vendvotime. Ky verifikim zbuloi devijime të konsiderueshme në votat e kandidatëve në disa komuna, me dallime që arrinin qindra vota për vendvotim. Këto gjetje tejkalonin kufijtë e gabimeve të zakonshme njerëzore dhe sinjalizonin mangësi në procesin e numërimit.

Më 13 janar, KQZ vendosi rinumërimin e plotë të vendvotimeve në 10 komuna (Prizren, Ferizaj, Sкен-deraj, Shtime, Vushtrri, Dragash, Mamushë, Kaçanik, Leposaviq dhe Ranillug) dhe 10% të vendvotimeve në pjesën tjetër të vendit. Demokracia në Veprim (DnV), qysh atëherë vlerësoi se kjo masë ishte e pam-jaftueshme për rikthimin e besimit publik, duke reko-manduar rinumërim të plotë në nivel vendi. Gjatë kësaj periudhe, disa anëtarë të KQZ-së dhe akterë politikë tentuan të minimizonin rëndësinë e devijimeve duke argumentuar se ato kishin ndikim të kufizuar në rezul-tatin përfundimtar, meqë rinumërimet prodhuan vetëm një mandat të ndryshuar. Megjithatë, vetë ekzistenca e dhjetëra mijëra votave të devijuara përbënte çështje thelbësore të besimit publik, pavarësisht ndikimit në mandatet parlamentare.

Pas presionit të shtuar publik dhe evidencës së vazh-dueshme të mospërputhjeve, më 19 janar KQZ mori vendim për rinumërim të plotë në nivel vendi. Ky vendim përbën ndërhyrjen më të rëndësishme korrigjuese në këtë proces zgjedhor dhe një hap të domosdoshëm për mbrojtjen e integritetit të rezultatit. Rinumërimi përfun-doi më 30 janar, pas rritjes së kapaciteteve operative të Qendrës së Numërimit dhe Rezultateve, ku numri i tavolinave të numërimit pothuajse u dyfishua dhe puna u zhvillua në dy ndërrime.

Megjithatë, menaxhimi institucional i fazës finale u sho-qërua me kontestime serioze procedurale. Më 31 janar, KQZ vazhdoi me shpalljen e rezultateve përfundimtare pa respektuar afatin ligjor 48-orësh, për ankesa lidhur me administrimin e numërimit. Po ashtu, procedura e trajtimit të rezultateve të subjektit politik Lista Serbe, u nda nga pjesa tjetër e procesit, duke krijuar precedent problematik në interpretimin e rregullave procedur-ale. Ky vendim i KQZ-së, megjithatë, u ndryshua nga PZAP-ja, pas ankesës së Listës Serbe – duke përfun-duar me shpallje të rezultateve edhe për këtë subjekt politik.

Në ndërkohë, hetimet e nisura nga organet e drejtësisë, fillimisht në komunën e Prizrenit, çuan në arrestimin e një numri të konsiderueshëm individësh të dyshuar për manipulim në procesin e numërimit. Vendimi i KQZ-së për shkarkimin e Komisionit Komunal Zgjedhor në Prizren përbën masë të rëndësishme, megjithëse praktika e njëjtë nuk u aplikua në mënyrë të barabartë në komuna të tjera problematike.

Në tërësi, performanca e KQZ-së gjatë këtyre zgjedh-jeve paraqet një kontrast mes administrimit profesional dhe transparent në fazën fillestare, i pasuar nga një menaxhim i vështirë i krizës së numërimit që ekspozoi dobësi në ndarjen e rolit politik dhe administrativ të institucionit. Vendimi për rinumërim të plotë mbrojt-i integritetin e rezultatit, por mënyra e trajtimit të krizës ndikoi në perceptimin publik për besueshmërinë e administratës zgjedhore.

4.2. Komisionet Komunale Zgjedhore dhe Këshillat e Vendvotimeve

Komisionet Komunale Zgjedhore (KKZ) përbëjnë hallkën kyçe ndërmjet administratës qendrore zgjedhore dhe strukturave në nivel vendvotimi, duke pasur përgjeg-jësi për zbatimin praktik të operacioneve zgjedhore në nivel lokal. Roli i tyre përfshin përgatitjen logjistike të procesit, koordinimin e Këshillave të Vendvotimeve, trajnimin e stafit zgjedhor dhe menaxhimin e materialit zgjedhor.

Demokracia në Veprim nuk ka zhvilluar vëzhgim të strukturuar dhe sistematik të punës së Komisioneve Komunale Zgjedhore gjatë kësaj periudhe zgjedhore. Për këtë arsye, ky raport nuk përmban vlerësim empirik të drejtpërdrejtë mbi performancën e tyre administra-tive.

Megjithatë, bazuar në informacionin publik të disponue-shëm, raportimet e KQZ-së dhe zhvillimet paszgjedh-hore të lidhura me procesin e numërimit, rezulton se funksionimi i disa strukturave komunale ka qenë pjesë e debatit publik, veçanërisht në komunat ku janë evidentuar devijime të konsiderueshme gjatë rinumërimit të votave preferenciale.

4.3. Puna në Qendrat Komunale të Numërimit

Qendrat Komunale të Numërimit (QKN) kanë pasur rol qendror në administrimin e procesit të numërimit të votave preferenciale për kandidatët, një nga elementet më të ndjeshme të këtyre zgjedhjeve. Sipas kornizës ligjore në fuqi, numërimi i votave të kandidatëve zhvillo-het jashtë vendvotimeve, në ambiente të centralizuara komunale, me qëllim standardizimin e procedurave dhe rritjen e kontrollit institucional mbi procesin.

Demokracia në Veprim nuk ka zhvilluar vëzhgim të strukturuar të përhershëm brenda Qendrave Komu-nale të Numërimit për shkak të kufizimeve operacionale dhe financiare. Për më tepër, vetë dinamika e procesit të numërimit ka ndikuar negativisht në mundësinë e mbikëqyrjes nga akterët e jashtëm. Numërimi i votave të kandidatëve është zhvilluar në periudhën menjëherë pas ditës së zgjedhjeve – përkatësisht më 29, 30 dhe

31 dhjetor, si dhe në ditët e para të janarit – që përkon me periudhën e festave zyrtare. Si pasojë, në shumë Qendra Komunale të Numërimit ka pasur ditë të tëra të numërimit, që janë zhvilluar pa prani të vëzhguesve, duke e kufizuar nivelin e monitorimit dhe transparencës së procesit.

Megjithëse DnV nuk ofron vlerësim empirik të drejt-përdrejtë mbi punën e përditshme të QKN-ve, zhvilli-met paszgjedhore që lidhen me procesin e rinumërimit e kanë vendosur funksionimin e këtyre qendrave në qendër të debatit publik dhe institucional.

Verifikimi fillestar i një mostre prej 2% të vendvoti-meve, i iniciuar nga KQZ pas shqyrtimit të materia-leve të regjistruara me kamera, evidentoi devijime të konsiderueshme ndërmjet rezultateve të numëruara në QKN dhe atyre të verifikuara gjatë rinumërimit. Në disa komuna, dallimet në votat preferenciale arritën në qindra raste për vendvotim, duke treguar se proble-met nuk ishin të izoluara dhe duke ngritur shqetësime serioze mbi saktësinë e administrimit të procesit të numërimit.

Këto gjetje çuan fillimisht në vendimin për rinumërim të plotë në dhjetë komuna dhe rinumërim të pjesshëm në pjesën tjetër të vendit, përpara se KQZ të vendoste për rinumërim të plotë në nivel vendi. Vetë fakti që një pjesë kaq e madhe e vendvotimeve rezultoi me mospërputhje të konsiderueshme tregon për mangësi strukturore në organizimin, trajnimin dhe mbikëqyrjen e procesit të numërimit në nivel komunal.

Rinumërimi i përgjithshëm, ndonëse i domosdoshëm për rikthimin e besimit publik, ekspozoi gjithashtu brishtësinë e modelit aktual të numërimit të cen-tralizuar të votave preferenciale. Ngarkesa e madhe administrative, presioni kohor dhe kompleksiteti i voti-mit preferencial me deri në dhjetë kandidatë rritën ndjeshëm rrezikun e gabimeve dhe devijimeve gjatë procesit.

Përvoja e këtyre zgjedhjeve rithekson nevojën për rishikim të thelluar të modelit të numërimit në Qendrat Komunale të Numërimit. Integriteti i rezultatit zgjed-hor nuk varet vetëm nga korrektësia e votimit, por në mënyrë të barabartë nga saktësia e numërimit.

4.4. Puna në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve

Qendra e Numërimit dhe Rezultateve (QNR) përfaqëson fazën përfundimtare të administrimit zgjedhor. Në këtë fazë përfshihen verifikimi i materialeve zgjedhore, numërimi i votave me kusht, votave nga jashtë vendit, si dhe realizimi i çdo rinumërimi të urdhëruar nga KQZ apo nga organet ankimore. Për këto zgjedhje, QNR u shndërrua në pikën qendrore të procesit paszgjedhor për shkak të volumit të rinumërimeve.

Demokracia në Veprim nuk ka zhvilluar vëzhgim konstant dhe sistematik në QNR për shkak të kufizimeve operacionale dhe financiare. Megjithatë, misioni ka realizuar vizita ad-hoc dhe verifikime të drejtpërdrejta të procedurave gjatë periudhës së numërimit dhe rinumërimit, si dhe ka ndjekur zhvillimet përmes kanaleve të drejtpërdrejta të komunikimit me zyrtarët përgjegjës të KQZ-së. Niveli i përgjithshëm i pranisë së vëzhguesve nga organizata të tjera, sidomos media dhe përfaqësues të subjekteve politike ishte i kënaqshëm, duke krijuar një mjedis relativisht të hapur për vëzhgim.

Procesi i pranimit dhe verifikimit të materialeve zgjedhore në QNR u zhvillua në përgjithësi në mënyrë të rregullt, megjithëse me ngarkesë operative. Numërimi i votave me kusht dhe votave nga jashtë vendit u zhvillua sipas procedurave të përcaktuara, me kontroll administrativ dhe verifikim të dokumentacionit përkatës. Votat me postë dhe votimi jashtë vendit përbënin një segment teknikisht të ndjeshëm të procesit, por administrimi i tyre në QNR nuk prodhoi kontestime madhore procedurale, me përjashtim të pretendimeve për pranim të pakove me fletëvotime, përtej disa prej afateve ligjore. Megjithatë, vëllimi i madh i materialeve dhe presioni kohor ndikuan në ritmin e punës dhe e zgjatën në një masë fazën përmbyllëse të procesit zgjedhor.

Në anën tjetër, pas verifikimit të mostrës fillestare prej 2% të vendvotimeve, e cila konfirmoi devijime të konsiderueshme në numërimin e votave preferenciale, QNR u përball me një rinumërim të plotë në nivel vendi. Rinumërimi i plotë zgjati mbi dy javë dhe përfundoi më 30 janar. Për të përballuar këtë ngarkesë, kapacitetet operative u rritën ndjeshëm përmes pothuajse dyfishimit të tavolinave të numërimit – nga rreth 20 në 38 – të cilat funksiononin në dy ndërrime.

Një nga aspektet më pozitive të punës në QNR ishte niveli i transparencës së procesit. Sikurse edhe nëpër QKN, çdo tavolinë numërimi ishte e mbuluar me kamera dhe procesi u transmetua drejtpërdrejt, duke mundësuar monitorim në kohë reale nga publiku, media dhe aktet tjerë politikë. Kjo masë krijoi një standard të lartë transparence dhe ndihmoi në uljen e ndjeshme të dyshimeve për ndërhyrje gjatë rinumërimit.

Pas përfundimit të rinumërimit të secilës kuti votimi, për të rritur transparencën, KQZ publikoi në faqen përkatëse zyrtare rezultatet e detajuara të ndryshimeve të prodhuara nga rinumërimi. Të dhënat u bënë të qasshme në nivel kombëtar, komunal dhe në nivel vendvotimi, për secilin subjekt politik dhe për secilin kandidat individual. Ky publikim i detajuar përbën një praktikë të rëndësishme për transparencë zgjedhore dhe një precedent pozitiv për dokumentimin publik të korrigjimeve të rezultatit.

Megjithatë, vetë fakti që ishte i nevojshëm një rinumërim total ekspozoi mangësi serioze në fazat paraprake të administrimit të numërimit në nivel komunal. Rinumërimi konfirmoi ekzistencën e një numri shumë të madh devijimesh në votat preferenciale. Edhe pse ndikimi formal në shpërndarjen e mandateve ishte minimal, përmasa e devijimeve ngriti shqetësime serioze për integritetin e administrimit të votës individuale dhe për besimin publik në proces.

Gjatë periudhës së rinumërimit, puna në QNR u zhvillua nën presion kohor dhe me ngarkesë operacionale. Në tërësi, puna në QNR dëshmoi se sistemi zgjedhor ka kapacitet për vetë-korrigjim përmes mekanizmave të rinumërimit dhe transparencës. Megjithatë, ky korrigjim erdhi si reagim ndaj një krize të thellë besimi dhe me kosto në kohë dhe sidomos perceptim publik. Integriteti teknik i rezultatit përfundimtar u rikthye – të paktën nominalisht – përmes rinumërimit total, por procesi nxori në pah dobësi strukturore që kërkojnë adresim sistemik.

4.5. Certifikimi i subjekteve politike dhe kandidatëve të tyre

Procesi i certifikimit të subjekteve politike dhe kandidatëve për zgjedhjet e parakohshme parlamentare të 28 dhjetorit 2025 u zhvillua brenda një afati të shkurtër kohor, përkatësisht nga 24 deri më 30 nëntor 2025. Gjatë kësaj periudhe aplikuan për certifikim 24 subjekte politike me gjithsej 1,180 kandidatë për deputetë.

Në përgjithësi, KQZ miratoi aplikimet e subjekteve politike, por procesi u shoqërua me vendime që ngritën sërish shqetësime për ndikim politik në vendimarrjen administrative. Rasti më problematik mbeti mos-certifikimi fillestar i Listës Serbe. Edhe në këtë cikël zgjedhor, KQZ refuzoi certifikimin e këtij subjekti politik, pavarësisht rekomandimit të Zyrës për Regjistrimin e Partive Politike se kriteret ligjore ishin përmbushur. Vendimi u korrigjua nga Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashpresa, që si i tillë u konfirmua më pas edhe nga Gjykata Supreme, të cilat konstatuan paligjshmërinë e veprimit të KQZ-së. Përsëritja e këtij rasti, tashmë në disa cikle zgjedhore radhazi, thellon perceptimin për mungesë të konsistencës dhe për cenim të pavarësisë së administratës zgjedhore në çështje që duhet të jenë strikt procedurale.

Një rast tjetër me rëndësi ishte refuzimi i certifikimit të kandidatës Ena Krasniqi nga lista e koalicionit Vakut. Organet ankimore vlerësuan se interpretimi formal i përkatësisë etnike mbi bazë të lidhjes familjare bie ndesh me parimin e përfaqësimit autentik të komuniteteve jo-shumicë. Ky vendim vendosi një standard të rëndësishëm për mbrojtjen e masave afirmative dhe për parandalimin e përdorimit të tyre në mënyrë abuzive.

Përbërja e listave të kandidatëve shpërfaqti një vazhdimësi të praktikave të mëparshme politike. Nga 1,180 kandidatë, 789 ishin burra (67%) dhe 391 gra (33%). Edhe pse kuota gjinore prej 30% është përmbushur minimalisht, përfaqësimi i grave mbetet kryesisht formal. Asnjë nga subjektet kryesore politike nuk ka kaluar pragun prej ~35% përfaqësim të grave, çka tregon mungesë të vullnetit politik për të shkuar përtej minimumit ligjor.

Edhe struktura e moshës së kandidatëve paraqet një profil relativisht homogjen. Grupmosha 41-50 vjeç përbën përqindjen më të madhe të listave, e ndjekur nga grupmosha 31-40 vjeç. Përfaqësimi i të rinjve mbetet i kufizuar, ndërsa kandidatët mbi 65 vjeç përbëjnë një pjesë të vogël të listave. Moshë mesatare e kandidatëve në subjektet kryesore politike sillet ndërmjet 42 dhe 46 vjeç, duke konfirmuar dominimin e profileve të konsoliduara politike.

Një karakteristikë e theksuar e këtyre zgjedhjeve është niveli i lartë i riciklimit të kandidatëve. 524 kandidatë (44%) kanë kandiduar edhe në zgjedhjet parlamentare të 9 shkurtit 2025, ndërsa 362 kandidatë (31%) kanë qenë pjesë e zgjedhjeve lokale të të njëjtit vit. 149 kandidatë (13%) kanë kandiduar në të dy proceset zgjedhore.

Procesi i certifikimit u ndikua gjithashtu nga ndryshimet ligjore të vitit 2023, të cilat ulën standardin e përshtatshmërisë juridike për kandidim. Ndalesa për pjesëmarrje në zgjedhje zbatohet vetëm për personat e dënuar me burgim efektiv mbi një vit, duke lejuar kandidimin e personave të dënuar me kusht, me gjobë apo me masa alternative, përfshirë rastet e ndërldhura me korrupsionin.

Në tërësi, procesi i certifikimit dëshmoi se administrata zgjedhore arriti të përmbyllë procedurat brenda afateve, por njëkohësisht ekspozoi dobësi në aspektin e pavarësisë vendimmarrëse dhe të standardeve të integritetit. Përbërja e listave konfirmon vazhdimësinë e modeleve ekzistuese të përfaqësimit, gjegjësisht përfshirjen gjinore minimale, praninë e kufizuar të të rinjve dhe riciklimin e kandidatëve.

4.6. Certifikimi i listës së votuesve dhe Shërbimi i Votuesve

Lista Përfundimtare e Votuesve për zgjedhjet e parakohshme parlamentare të 28 dhjetorit 2025 është përpiluar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve mbi bazën e të dhënave të Regjistrit Qendror Civil, të administruar nga Agjencia për Regjistrim Civil në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme. Për përgatitjen e listës, KQZ ka pranuar disa ekstrakte nga Departamenti i Gjendjes Civile dhe Departamenti për Prodhimin e Dokumenteve, të cilat janë përdorur për verifikimin

dhe përditësimin e të dhënave të zgjedhësve përmes krahasimeve ndërinstytucionale.

Ekstrakti fillestar i Regjistrit Qendror Civil, i pranuar më 21 nëntor 2025, përmbante 2,082,699 votues. Pas procesit të verifikimit, nga lista janë larguar 6,360 persona, përfshirë persona të evidentuar si të vdekur përmes krahasimit me të dhënat e Departamentit të Pensioneve dhe verifikimeve të kryera nga zyrat komunale të regjistrimit civil, si dhe persona mbi moshën 100 vjeç të identifikuar përmes krahasimit me të dhënat e Regjistrimit të Popullsisë 2024. Në të njëjtën kohë, në listë janë përfshirë qytetarë që kishin paraqitur kërkesa për përfshirje apo korrigjim gjatë periudhës së Shërbimit të Votuesve.

Lista Përfundimtare e Votuesve për këto zgjedhje përmbante 2,076,290 votues. Edhe pse procesi i pastrimit ka rezultuar me një reduktim të numrit të përgjithshëm, numri i votuesve në listë vazhdon të jetë dukshëm më i lartë sesa popullsia rezidente e Kosovës sipas regjistrimit të fundit. Ky disproporcion mbetet një problem i vazhdueshëm që ndikon drejtpërdrejt në perceptimin publik për saktësinë e listës së votuesve dhe për integritetin e procesit zgjedhor. Krahasuar me zgjedhjet parlamentare të shkurtit 2025, rritja neto e listës është modeste dhe lidhet kryesisht me përfshirjen e votuesve të rinj që kanë mbushur moshën madhore ndërmjet dy proceseve zgjedhore.

Nga numri i përgjithshëm i votuesve, 1,999,204 ishin të regjistruar për votim brenda Kosovës, ndërsa 77,016 votues ishin përfshirë në listën e votimit jashtë vendit. KQZ ka vazhduar të kërkojë bashkëpunim me institucionet relevante për përditësimin e të dhënave, megjithatë mungesa e një sistemi të integruar dhe të automatizuar për sinkronizimin e regjistrave shtetërorë mbetet një pengesë serioze për pastrimin e plotë të listës së votuesve.

Në kuadër të përgatitjes së listës përfundimtare, KQZ ofroi Shërbimin e Votuesve nga 26 nëntori deri më 7 dhjetor 2025. Gjatë kësaj periudhe qytetarët patën mundësi të verifikojnë të dhënat personale, qendrën e votimit dhe të kërkojnë korrigjime apo ndryshime të vendvotimit. Edhe pse ky mekanizëm mbetet një instrument i rëndësishëm për përditësimin e listës,

afati i shkurtër kohor kufizoi mundësinë për adresim më të gjerë të pasaktësive dhe për komunikim efektiv me votuesit, sidomos në komunat me ngarkesë të lartë administrative.

Sa i përket organizimit të votimit, KQZ miratoi funksionimin e 948 qendrave të votimit në Kosovë, prej të cilave 910 qendra të rregullta dhe 38 qendra votimi me kusht. Në total u funksionalizuan 2,614 vendvotime, përfshirë 2,557 vendvotime të rregullta dhe 57 vendvotime me kusht. Vendvotimet me kusht shërbyen për të adresuar raste të veçanta të votuesve që nuk figuronin në listën e qendrës së tyre të zakonshme të votimit.

Në përgjithësi, KQZ ka përmbushur detyrimet ligjore lidhur me përpilimin e listës së votuesve dhe organizimin e qendrave të votimit. Megjithatë, mospërputhja e vazhdueshme ndërmjet numrit të votuesve të regjistruar dhe popullsisë reale të vendit mbetet një sfidë serioze. Kjo çështje tejkalon një cikël zgjedhor të vetëm dhe kërkon reforma afatgjata në menaxhimin e regjistrave civilë dhe në koordinimin ndërinstytucional.


KOMUNA	NR. I VOTUESVE	QENDRA VOTIMI (përfshirë ato me kusht)	VENDVOTIME (përfshirë ato me kusht)
 Deçan	 41,138	 15	 51
 Gjakovë	 120,712	 37	 147
 Drenas	 56,671	 32	 74
 Gjilan	 104,870	 38	 132
 Dragash	 41,012	 34	 58
 Istog	 50,553	 23	 63
 Kaçanik	 33,070	 22	 46
 Klinë	 50,711	 22	 64
 Fushë Kosovë	 52,006	 17	 65

KOMUNA	NR. I VOTUESVE	QENDRA VOTIMI (përfshirë ato me kusht)	VENDVOTIME (përfshirë ato me kusht)
 Kamenicë	 33,056	 29	 51
 Mitrovicë e Jugut	 81,478	 33	 104
 Leposaviq	 12,453	 19	 26
 Lipjan	 64,840	 35	 86
 Novobërdë	 10,037	 19	 24
 Obiliq	 25,583	 15	 34
 Rahovec	 59,309	 35	 79
 Pejë	 117,413	 31	 141
 Podujevë	 84,396	 48	 112

KOMUNA	NR. I VOTUESVE	QENDRA VOTIMI (përfshirë ato me kusht)	VENDVOTIME (përfshirë ato me kusht)
 Prishtinë	 219,516	 55	 270
 Prizren	 187,233	 77	 238
 Skenderaj	 53,329	 34	 74
 Shtime	 27,783	 16	 35
 Shtërpçë	 12,359	 10	 18
 Suharekë	 70,191	 35	 90
 Ferizaj	 121,287	 48	 155
 Viti	 49,162	 31	 65
 Vushtrri	 74,580	 33	 97

KOMUNA	NR. I VOTUESVE	QENDRA VOTIMI (përfshirë ato me kusht)	VENDVOTIME (përfshirë ato me kusht)
 Zubin Potok	 6,498	 13	 16
 Zvečan	 6,871	 7	 12
 Malishevë	 56,894	 36	 76
 Junik	 5,480	 2	 7
 Mamushë	 4,683	 2	 7
 Hani i Elezit	 8,683	 5	 12
 Graçanicë	 24,414	 15	 34
 Ranillug	 4,856	 8	 11
 Partesh	 4,772	 4	 8

KOMUNA	NR. I VOTUESVE	QENDRA VOTIMI (përfshirë ato me kusht)	VENDVOTIME (përfshirë ato me kusht)
 Klokot	 4,139	 6	 9
 Mitrovica E Veriut	 17,531	 7	 23



4.7 Votimi jashtë vendit

Votimi jashtë Kosovës për zgjedhjet e parakohshme parlamentare të 28 dhjetorit 2025 ishte një nga komponentët më kompleks të administrimit zgjedhor, për shkak të afateve të shkurtra kohore dhe organizimit logjistik në shumë shtete. Procesi i regjistrimit të votuesve jashtë Kosovës u zhvillua nga 26 nëntori deri më 6 dhjetor 2025. Pas shqyrtimit të aplikimeve dhe ankesave nga Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parash-tresa, lista përfundimtare përfshiu 77,016 votues. Në përputhje me ligjin, këta votues u larguan nga lista e votuesve brenda Kosovës.

Organizimi i votimit fizik jashtë vendit u shoqërua fillimisht, me një kontest institucional lidhur me vendndodhjen e qendrave të votimit. Së pari, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve kishte vendosur që votimi të zhvillohej në 50 përfaqësi diplomatike, me 66 vendvotime në 36 shtete. Në të njëjtin vendim ishte paraparë edhe hapja e qendrave shtesë të votimit jashtë hapësirave diplomatike, mbi bazën e rekomandimeve të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës.

Ky vendim u kundërshtua në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parash-tresa, i cili e anuloi pjesën e vendimit që lejonte hapjen e qendrave të votimit jashtë përfaqësive diplomatike, duke vlerësuar se një praktikë e tillë binte ndesh me kornizën ligjore në fuqi. PZAP theksoi se kufizimi i votimit në hapësirat diplomatike përbën një mekanizëm mbrojtës për integritetin e votës dhe nuk përbën pengesë të pajustificuar për votuesit jashtë vendit. Debat i rreth këtij vendimi ekspozoi tensione të dukshme politike dhe akuza të ndërsjella për tejkalim të kompetencave institucionale, duke e politizuar në masë të konsiderueshme administrimin e këtij segmenti të procesit zgjedhor.

Votimi fizik u zhvillua më 27 dhjetor 2025 në 29 përfaqësi diplomatike të Republikës së Kosovës, përkatësisht në 16 ambasada dhe 13 konsullata, në 18 shtete.

Në këtë proces ishin të regjistruar 19,187 votues, ndërsa votuan 16,165 qytetarë, që përfaqëson një pjesëmarrje prej 84.24%. Procesi i votimit u zhvillua gjatë orarit zyrtar dhe vetëm për votuesit e regjistruar parapakisht për këtë mënyrë votimi.

Sa i përket votimit me postë, rreth 58 mijë votues ishin të regjistruar për këtë formë votimi. Përveç kutisë postare të KQZ-së në Kosovë, u funksionalizuan kuti postare në 23 shtete. Procesi i dërgimit të fletëvotimeve filloi më 14 dhjetor 2025. Sipas të dhënave zyrtare, shumica dërrmuese e dërgesave arritën tek votuesit, ndërsa rastet e papërfunduara lidhen kryesisht me probleme të adresave ose mungesë të votuesit gjatë dorëzimit.

Numri i zarfeve të pranuar nga diaspora ishte afërsisht 69 mijë. Pas verifikimit në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve, rreth 63 mijë zarfe u aprovuan, ndërsa më pak se 5 mijë u refuzuan për arsye procedurale dhe teknike, përfshirë raste të votimit të dyfishtë të tentuar, zarfe pa vulë postare dhe dërgesa të shumëfishta nga i njëjti votues.

Në përgjithësi, votimi jashtë Kosovës dëshmoi një interes të lartë dhe të qëndrueshëm të diasporës për pjesëmarrje në procesin demokratik. Megjithatë, ky segment mbetet një nga komponentët më të ndjeshëm të procesit zgjedhor, me sfida të vazhdueshme në aspektin e logjistikës, sigurisë, transparencës dhe besueshmërisë institucionale, të cilat kërkojnë adresim sistematik përtej cikleve zgjedhore.

5. FUSHATA ZGJEDHORE

Fushata zgjedhore për zgjedhjet e parakohshme parlamentare të 28 dhjetorit 2025, sipas vëzhgimit të Demokracisë në Veprim (DnV), është zhvilluar në një ambient përgjithësisht të qetë dhe pa incidente serioze të sigurisë. Aktivitetet politike janë zhvilluar rregullisht në të gjitha pjesët e vendit, duke reflektuar një konkurrencë aktive ndërmjet subjekteve politike. Megjithatë, krahasuar me ciklet e mëparshme zgjedhore, është vërejtur një nivel më i ulët i mobilizimit qytetar, si në pjesëmarrjen në aktivitete publike ashtu edhe në intensitetin e përgjithshëm të fushatës në terren.

Pjesëmarrja e qytetarëve në aktivitetet zgjedhore ka ndryshuar ndjeshëm ndërmjet subjekteve politike dhe formave të organizimit. Ndërsa tubimet kryesore dhe prezantimet e listave kanë tërhequr pjesëmarrje më të gjerë, shumica e aktiviteteve janë karakterizuar nga pjesëmarrje e mesme ose e kufizuar dhe janë zhvilluar kryesisht në ambiente të mbyllura. Shtrirja gjeografike e fushatës ka qenë e përqendruar kryesisht në qendrat urbane dhe komunat me peshë më të madhe elektorale, ndërsa komunat më të vogla kanë qenë më pak të përfshira në agjendën e aktiviteteve politike. Ky koncentrim ka reflektuar një orientim strategjik të subjekteve politike drejt zonave me ndikim më të madh elektoral, por njëkohësisht ka kufizuar ekspozimin e një pjese të elektoratit ndaj ofertave programore.

Fushata ka qenë dukshëm e personalizuar dhe e centralizuar. Në shumicën dërrmuese të aktiviteteve publike, figurat dominuese kanë qenë liderët partiakë ose kandidatët për kryeministër, ndërsa kandidatët për deputetë kanë pasur rol dytësor dhe kryesisht mbështetës. Edhe në rastet kur janë organizuar aktivitete pa praninë e liderit, këto kanë qenë takime të vogla me ndikim të kufizuar publik. Ky model organizimi ka reduktuar hapësirën për prezantim të drejtpërdrejtë programor nga ana e kandidatëve për deputetë dhe ka kufizuar pluralizmin e mesazheve brenda vetë subjekteve politike, duke e përqendruar në një masë komunikimin politik rreth figurave qendrore dhe jo rreth platformave.

Përfaqësimi dhe gjithëpërfshirja kanë mbetur ndër sfidat më të theksuara të kësaj fushate. Gratë kanë qenë të nënpërfaqësuar si folëse në aktivitetet publike, ndërsa në një numër të konsiderueshëm aktiviteteesh nuk ka pasur fare gra në role përfaqësuese. Edhe pse përfaqësimi gjinor në lista përmbush pragun ligjor, dinamika e fushatës ka treguar se hapësira reale për zë publik dhe ekspozim politik për gratë mbetet e kufizuar. Në mënyrë të ngjashme, të rinjtë kanë qenë kryesisht të pranishëm në role organizative, mobilizuese dhe logjistike, ndërsa përfshirja e tyre në role përfaqësuese dhe vendimmarrëse ka qenë e kufizuar. Personat me aftësi të kufizuara kanë qenë pothuajse të padukshëm gjatë gjithë periudhës së fushatës, si në aspektin e përfaqësimit, ashtu edhe të pjesëmarrjes në aktivitetet publike, duke reflektuar mangësi strukturore në gjithëpërfshirjen politike.

Diskursi politik gjatë fushatës është përqendruar kryesisht në tema ekonomike, sociale dhe të sigurisë. Çështje si punësimi, pagat, mirëqenia sociale, arsimi, shëndetësia, infrastruktura dhe orientimi euroatlantik kanë dominuar mesazhet publike të subjekteve politike. Premtimet për rritje pagash dhe forcim të skemave sociale kanë qenë ndër temat më të artikuluar, të pranishme pothuajse në të gjitha programet dhe komunikimet elektorale, pavarësisht dallimeve, profileve dhe orientimeve potencialisht ideologjike ndërmjet subjekteve. Megjithatë, në shumë raste këto premtime janë shoqëruar me pak detaje mbi mekanizmat e zbatimit dhe koston e tyre financiare, duke e kufizuar debatin publik mbi potencialin real të zbatimit të tyre.

Sa i përket tonit të fushatës, gjuha e përdorur ka qenë kryesisht mobilizuese dhe kritike ndaj kundërshtarëve politikë, por pa përshkallëzim të gjuhës fyese apo diskriminuese. Raste të gjuhës që nxit tension apo përdor shprehje fyese kanë qenë të izoluara dhe nuk përbëjnë tipar dominues të kësaj fushate, çka paraqet një ndryshim të dukshëm krahasuar me zgjedhjet e mëparshme. Ky zhvillim sugjeron një përpjekje të sub-

6. VËZHGIMI I ZGJEDHJEVE

jekteve politike për të mbajtur një nivel më të kontrolluar të komunikimit publik, ndonëse polarizimi politik mbetet i pranishëm në përmbajtje.

Subjektet politike kanë shfrytëzuar gjerësisht takimet direkte, mediat tradicionale dhe platformat digjitale si mjetet kryesore të komunikimit politik. Përdorimi intensiv i rrjeteve sociale ka zgjeruar shtrirjen e mesazheve politike dhe ka rritur ndërveprimin me qytetarët, por njëkohësisht ka kontribuar në thjeshtimin e diskursit politik dhe zhvendosjen e debatit nga përmbajtja programore drejt mesazheve të shkurtra dhe simbolike. Ky trend pasqyron transformimin gradual të komunikimit elektoral, ku forma po fiton peshë krahas përmbajtjes.

Megjithëse fushata është zhvilluar pa incidente madhore, çështja e barazisë së garës zgjedhore mbetet shqetësuese. DnV ka evidentuar raste të shfrytëzimit të resurseve publike për qëllime elektorale. Vendimi i Qeverisë për ndarjen e mjeteve financiare për pensionistët dhe fëmijët vetëm pak ditë para Ditës së Zgjedhjeve përbën një ndërhyrje me ndikim të drejtpërdrejtë në ambientin elektoral. Edhe pse masa të tilla mund të kenë bazë sociale, koha e miratimit dhe mënyra e komunikimit publik krijojnë perceptimin e përdorimit të resurseve shtetërore për përfitim politik, duke cenuar parimin e barazisë së garës dhe besimin publik në integritetin e procesit zgjedhor.

Zgjedhjet e parakohshme parlamentare të 28 dhjetorit 2025 u zhvilluan nën vëzhgim të një numri të konsiderueshëm akterësh, përfshirë përfaqësues të subjekteve politike, organizata të shoqërisë civile, media, si dhe disa akterë ndërkombëtarë. Në total, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve akreditoi 19,254 vëzhgues, që si numër dëshmon një interes të lartë për vëzhgimin dhe transparencën e procesit zgjedhor.

Pjesa dërmuese e vëzhguesve të akredituar i përkiste subjekteve politike, të cilat në total akredituan 17,614 vëzhgues. Kjo përbërje reflekton rolin dominues që partitë politike vazhdojnë të kenë në procesin e vëzhgimit të zgjedhjeve, veçanërisht në nivelin e vendvotimeve dhe të numërimit të votave. Megjithatë, dominimi i vëzhguesve partiakë nënvizon edhe rëndësinë e balancimit të këtij pranie me vëzhgim të pavarur dhe profesional.

Shoqëria civile u përfaqësua me 809 vëzhgues të akredituar, duke kontribuar në monitorimin e pavarur të procesit zgjedhor, përfshirë Ditën e Zgjedhjeve, numërimit të votave dhe proceset paszgjedhore. Misioni i vetëm vendor i vëzhgimit ishte "Demokracia në Veprim", që akreditoi dhe angazhoi një rrjet prej rreth 600 vëzhguesish në të gjithë territorin e Kosovës. Vëzhgimi përfshiu periudhën përgatitore të zgjedhjeve, zhvillimet gjatë fushatës zgjedhore, Ditën e Votimit dhe fazën paszgjedhore – e kufizuar kryesisht në ndjekjen e punës së Qendrës së Numërimit dhe Rezultateve (QNR) – me synim dokumentimin e rregullsisë së procedurave dhe funksionimit të institucioneve zgjedhore në tërësi.

Prania e organizatave vendore të vëzhgimit mbetet veçanërisht e rëndësishme në kontekstin e kufizimit të misioneve ndërkombëtare dhe rritjes së përgjegjësisë së aktorëve vendorë për garantimin e integritetit të procesit.

Në këtë proces zgjedhor u akredituan gjithashtu 121 vëzhgues nga organizata ndërkombëtare dhe 13 përfaqësues nga përfaqësitë diplomatike, ndërsa vëzhgimi

7. DITA E ZGJEDHJEVE

mediatik u realizua nga 554 gazetarë të mediave vendore dhe 77 përfaqësues të mediave ndërkombëtare. Për më tepër, 66 vëzhgues u akredituan nga institucione shtetërore, në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.

Data e mbajtjes së zgjedhjeve në fund të muajit dhjetor, në periudhën e festave të fundvitit, ndikoi në nivelin e përgjithshëm të vëzhgimit, e veçanërisht nga misionet ndërkombëtare. Si pasojë, pesha e vëzhgimit vendor dhe e organizatave të shoqërisë civile rezultoi edhe më e rëndësishme për mbulimin e procesit zgjedhor. Në përgjithësi, numri i lartë i vëzhguesve të akredituar ka kontribuar në rritjen e transparencës së procesit zgjedhor.

Demokracia në Veprim ka vëzhguar mbarëvajtjen e procesit në Ditën e Zgjedhjeve përmes 500 vëzhguesve afatshkurtër të shpërndarë në 500 vendvotime sipas një mostre përfaqësuese. Raportimi për ecurinë e procesit dhe numërimin e rezultateve preliminare për subjektet politike është bërë sipas metodologjisë së Numërimit Paralel të Votave (PVT), e cila i ka mundësuar misionit sigurimin e të dhënave të besueshme dhe verifikueshme në nivel vendi.

Demokracia në Veprim vlerëson se Dita e Zgjedhjeve u zhvillua përgjithësisht në një atmosferë të qetë dhe demokratike, pa incidente serioze që do të cenonin integritetin e përgjithshëm të procesit. Procesi u karakterizua nga një administrim korrekt dhe nga respektim i përgjithshëm i procedurave themelore zgjedhore. Parregullsitë e evidentuara kanë qenë kryesisht të natyrës procedurale dhe teknike, të shpërndara në mënyrë jo të njëtrajtshme dhe pa ndikim në rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve.

Megjithatë, natyra e disa prej këtyre parregullsive shpërfaqë mangësi të vazhdueshme strukturore në administrimin zgjedhor, veçanërisht në aspektin e standardizimit të zbatimit të rregullave në terren.

Identifikimi i votuesve dhe Lista e Votuesve

Gjatë gjithë ditës së votimit nuk është raportuar për raste sistematike të identifikimit të votuesve me dokumente të shteteve të tjera apo dokumente të UNMIK-ut. Në pjesën dërmuese të vendvotimeve nuk është shënuar asnjë rast i tillë, ndërsa rastet e izoluara kanë qenë të kufizuara në numra shumë të vegjël. Ky është një tregues pozitiv i respektimit të rregullave bazë të identifikimit dhe i ndërgjegjësimit të administratës zgjedhore për rëndësinë e integritetit të procesit.

Ndryshe nga kjo, identifikimi i votuesve me dokumente të Kosovës me afat të skaduar ka qenë dukuri më e

përhapur. Raste të tilla janë raportuar në afërsisht një të tretën e vendvotimeve. Edhe pse në shumicën e rasteve bëhej fjalë për numra të ulët, prania e kësaj praktike dëshmon për një zbatim jo plotësisht koherent të rregullave dhe për mungesë të qartësisë në interpretimin e tyre nga komisionerët.

Një nga problematikat më të shprehura gjatë Ditës së Zgjedhjeve ishte vështirësia e votuesve për të gjetur emrin e tyre në Listën e Votuesve. Vetëm në rreth një të tretën e vendvotimeve nuk është raportuar asnjë rast i tillë, ndërsa në pjesën tjetër janë evidentuar raste të ndryshme, nga incidente sporadike deri në situata ku një numër më i konsiderueshëm votuesish nuk e kanë gjetur emrin në listë. Kjo problematikë lidhet kryesisht me ndryshimet në caktimin e qendrave të votimit dhe me jo-efikasitet të informimit të votuesve. Përveç konfuzionit të krijuar për votuesit, kjo situatë ka shkaktuar vonesa të panevojshme në disa qendra votimi.

Ankesat se dikush tjetër kishte nënshkruar në emër të votuesit kanë qenë të rralla dhe të izoluara, pa tregues për një problem sistematik. Kjo sugjeron se, pavarësisht sfidave teknike, integriteti bazë i listës së votuesve ka mbetur i paprekur në shumicën dërrmuese të rasteve.

Votimi me asistencë

Zbatimi i rregullave më të rrepta për votimin me asistencë ka rezultuar në një ulje të ndjeshme të këtij fenomeni krahasuar me proceset e mëparshme zgjedhore. Më pak se 1% e votuesve kanë votuar me asistencë, çka përfaqëson një përmirësim të dukshëm në kufizimin e keqpërdorimeve të mundshme. Kjo tregon se masat e ndërmarra nga administrata zgjedhore për kontroll më rigoroz kanë dhënë efekt të matshëm.

Komisionerët, në shumicën dërrmuese të vendvotimeve, kanë kërkuar dokumente mjekësore ose prova të tjera për të lejuar votimin me asistencë, duke reflektuar një zbatim më rigoroz të rregullave përkatëse. Në të njëjtën kohë, janë raportuar edhe raste kur votuesve nuk u është lejuar të votojnë me asistencë, pavarësisht kërkesës së tyre, për shkak të mungesës së dokumentacionit përkatës. Kjo ka qenë e shprehur në mbi 55% të vendvotimeve, e madje, në rreth 7% të tyre, kjo ka qenë e shprehur në mbi 10 raste gjatë ditës.

Rastet kur persona në moshë të re kanë kërkuar të votojnë me asistencë kanë qenë të pakta dhe të izoluara, ndërsa mosregjistrimi i votimit me asistencë në Librin e Votimit është evidentuar vetëm në rreth 10% të vendvotimeve, zakonisht në numra të kufizuar rastesh.

Fshehtësia e votës dhe parregullsi të tjera procedurale

Në shumicën e vendvotimeve është respektuar rregulli që ndalon praninë e më shumë se një votuesi prapa kabinës së votimit, përjashtuar rastet e lejuara të asistencës. Megjithatë, në rreth 20% të vendvotimeve ku është evidentuar një parregullsi e tillë, janë raportuar raste të izoluara deri në 10 raste, ku ky parim nuk është respektuar, duke krijuar rreziqe potenciale për cenimin e fshehtësisë së votës.

Fotografimi i fletëvotimit, ndonëse në përmasa të kufizuara, ka vazhduar të shfaqet edhe në këto zgjedhje. Gjatë gjithë ditës janë raportuar gjithsej 32 raste të tilla. Edhe pse numri mbetet relativisht i ulët, ky fenomen mbetet shqetësues për shkak të lidhjes së tij me blerjen e votës, frikësimin e votuesve dhe deformimin e vullnetit të lirë zgjedhor.

Mbyllja e vendvotimeve dhe fillimi i numërimit

Procesi i votimit është mbyllur me kohë në shumicën dërrmuese të vendvotimeve. Në një pjesë të kufizuar të vendvotimeve ka pasur votues që kanë pritur në radhë në orën 19:00 dhe të cilëve u është lejuar të votojnë, në përputhje me procedurat ligjore. Rastet e mbylljes para orarit apo vonesat më të theksuara kanë qenë tejet të rralla dhe pa ndikim domethënës në proces.

Gjatë fazës fillestare të numërimit, janë raportuar vetëm raste të izoluara ku është ngritur çështja e mospërputhjes së kodeve ose numrave serik të fletëvotimeve, si dhe përpjekje sporadike për numërimin e votave të kandidatëve në vendvotime. Këto raste nuk kanë qenë të përhapura dhe nuk kanë ndikuar në rrjedhën e përgjithshme të procesit.

8. REZULTATET DHE PROCESI PASZGJEDHOR

Publikimi i rezultateve dhe zhvillimet pas Ditës së Zgjedhjeve

Publikimi i shpejtë dhe pothuajse i plotë i rezultateve preliminare nga KQZ, me mbi 99% të rezultateve të publikuara brenda pak orësh, përbën një nga aspektet më pozitive të këtij procesi. Funksionimi stabil i sistemeve digjitale shënon një përmirësim të dukshëm krahasuar me ciklet e mëparshme zgjedhore dhe ka kontribuar ndjeshëm në rritjen e transparencës dhe besimit publik. Kurse, pranimi i shpejtë i rezultateve nga subjektet politike kryesore ndihmoi në ruajtjen e një klime të qetë paszgjedhore dhe reflektoi një nivel më të lartë të pjekurisë politike.

Rezultatet preliminare të DnV-së

Sipas të dhënave të mbledhura nga vëzhguesit e Demokracisë në Veprim (DnV), dalja e përgjithshme e votuesve deri në mbyllje të vendvotimeve ishte 45%, me margjinë gabimi prej $\pm 0,76\%$. Kjo përqindje nuk përfshinte votat me kusht, votat nga jashtë vendit dhe votat e personave me nevoja të veçanta.

Dalja e votuesve gjatë ditës kishte shënuar rritje progresive dhe ka qenë e shpërndarë në mënyrë relativisht të qëndrueshme përgjatë intervaleve kohore të vëzhguara. Deri në orën 12:00, pjesëmarrja në votim ishte 13,7%, ndërsa deri në orën 17:00 kishte arritur në 38,8%. Këto të dhëna tregojnë një interesim gradual të qytetarëve për të marrë pjesë në procesin zgjedhor, me intensifikim të votimit në orët e pasdites.

Bazuar në të dhënat preliminare të Numërimit Paralel të Votave (PVT), të mbledhura nga vëzhguesit e DnV-së në terren, rezultatet preliminare për subjektet politike – pa përfshirë votat me kusht, votat nga jashtë vendit dhe votat e personave me nevoja të veçanta – ishin:

Rezultatet preliminare të DnV-së në ditën e zgjedhjeve

Lëvizja Vetëvendosje (LVV)	48,56% (margjina e gabimit $\pm 1,44\%$)
Partia Demokratike e Kosovës (PDK)	20,97% (margjina e gabimit $\pm 1,27\%$)
Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK)	13,40% (margjina e gabimit $\pm 0,72\%$)
Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK)	5,24% (margjina e gabimit $\pm 1,60\%$)
Nisma Socialdemokrate (NISMA)	1,77% (margjina e gabimit $\pm 0,53\%$)
Srpska Lista (SL)	5,24% (margjina e gabimit $\pm 1,60\%$)
Za Slobodu, Pravdu i Opstanak (SPO)	0,61% (margjina e gabimit $\pm 0,17\%$)

Procesi paszgjedhor

Faza paszgjedhore e zgjedhjeve të parakohshme parlamentare të 28 dhjetorit 2025 u karakterizua nga një proces i zgjatur dhe intensiv verifikimi të rezultateve, i dominuar nga rinumërimi i plotë i votave preferenciale të kandidatëve. Nga dita e zgjedhjeve deri në shpalljen e rezultateve përfundimtare më 31 janar 2026 kaluan gjithsej 34 ditë, ndërsa deri në certifikim e tyre më 9 shkurt, kaluan plot 44 ditë. Kjo periudhë tejkalon pritshmëritë për një proces të zakonshëm administrativ, por që në këtë rast lidhet drejtpërdrejt me shkallën e korrigjimeve të evidentuara gjatë numërimit.

Certifikimi i rezultateve përfundimtare ndodhi pas përmbylljes së procedurave ankimore në organet kompetente. Pas shpalljes së rezultateve, në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa u parashtruan gjithsej shtatë ankesa që lidhen me fazën përfundimtare të procesit. Gjashtë prej këtyre rasteve u apeluar më tej në Gjykatën Supreme. Të gjitha ankesat u refuzuan, duke konfirmuar vlefshmërinë e rezultateve të shpallura. Pas përfundimit të këtij procesi juridik, më 9 shkurt 2026, KQZ-ja certifikoi rezultatet përfundimtare me vendim unanim. Certifikimi shënoi përmbylljen formale të ciklit zgjedhor dhe kalimin e procesit në fazën e implementimit institucional të rezultateve.

Ndryshe nga ciklet e mëparshme zgjedhore, ku sfidat kryesore lidhen me publikimin e rezultateve apo me dështime teknike të sistemeve digjitale, ky proces paszgjedhor u përcaktua kryesisht nga nevoja për rishikim substancial të votave preferenciale. Rinumërimi përbënte një proces të gjerë korrektues, i cili synonte adresimin e problemeve nga devijimet masive, posaçërisht në votat e kandidatëve, në mes të dhënave nga numërimet nëpër Qendra Komunale të Numërimit dhe rinumërimet në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve.

Në total, procesi i rinumërimit prodhoi 242,616 ndryshime në vota preferenciale, përfshirë 131,093 korrigjime negative (heqje votash) dhe 111,523 korrigjime pozitive (shtim votash). Ky volum i devijimeve tejkalon qartë nivelin e gabimeve “njerëzore” që mund të priten në një proces masiv numërimi. Këto nuk përfaqësojnë zhdukje apo shtim fizik të votave, por pasqyrojnë rishikime në regjistrimin e preferencave të kandi-

datëve gjatë fazës së tabulimit. Megjithëse bilanci neto i ndryshimeve mbetet negativ – me rreth 20 mijë vota sosh; rëndësia kryesore nuk qëndron tek diferenca si e tillë, por tek volumi i lartë i korrigjimeve që u desh të bëheshin pas procesit fillestar të numërimit.

Shpërndarja territoriale e devijimeve nuk ishte e njëtrajtshme. Disa komuna regjistruan nivele disproporcionale të korrigjimeve. Prizreni kryeson me 68,000 ndryshime në kuadër të votave të kandidatëve – që përbëjnë rreth 30% të të gjitha devijimeve. Prizreni pasohet nga Prishtina me 20,368 vota preferenciale të devijuara, Peja me 17,125 dhe Malisheva me 17,014 sosh. Vetëm këto katër komuna përbëjnë më shumë se gjysmën e të gjitha ndryshimeve të regjistruara në nivel vendi. Komuna të tjera me devijime të konsiderueshme përfshijnë Podujevën (10,389), Ferizajn (9,106), Gjakovën (9,240) dhe Mitrovicën e Jugut (8,175).

KOMUNA	DIFERENCA (negative)	DIFERENCA (pozitive)	DIFERENCA (neto)
 Deçan	-1476	1261	2737
 Gjakovë	-5151	4089	9240
 Drenas	-2118	2402	4520
 Gjilan	-3562	3943	7505
 Dragash	-1582	861	2443
 Istog	-1344	1591	2935
 Kaçanik	-1572	1531	3103
 Klinë	-2629	2394	5023
 Fushë Kosovë	-1677	1852	3529

KOMUNA	DIFERENCA (negative)	DIFERENCA (pozitive)	DIFERENCA (neto)
 Kamenicë	-812	1117	1929
 Mitrovicë e Jugut	-4102	4073	8175
 Leposaviq	-341	331	672
 Lipjan	-2455	2901	5356
 Novobërdë	-1048	457	1505
 Obiliq	-3059	1632	4691
 Rahovec	-2887	2493	5380
 Pejë	-10068	7057	17125
 Podujevë	-5741	4648	10389

KOMUNA	DIFERENCA (negative)	DIFERENCA (pozitive)	DIFERENCA (neto)
 Prishtinë	-9012	11356	20368
 Prizren	-40480	27520	68000
 Skenderaj	-2091	2037	4128
 Shtime	-1521	1241	2762
 Shtërpçë	-680	463	1143
 Suharekë	-3939	2636	6575
 Ferizaj	-4272	4834	9106
 Viti	-2775	3184	5959
 Vushtrri	-2578	3071	5649

KOMUNA	DIFERENCA (negative)	DIFERENCA (pozitive)	DIFERENCA (neto)
 Zubin Potok	-112	214	326
 Zveçan	-347	326	673
 Malishevë	-9044	7970	17014
 Junik	-131	107	238
 Mamushë	-265	109	374
 Hani i Elezit	-282	281	563
 Graçanicë	-1110	668	1778
 Ranillug	-63	206	269
 Partesh	-96	102	198

KOMUNA	DIFERENCA (negative)	DIFERENCA (pozitive)	DIFERENCA (neto)
 Klllokot	-290	190	480
 Mitrovica E Veriut	-381	375	756




Tabela: Diferenca negative, pozitive dhe neto – mes votave të kandidatëve të subjekteve politike, gjatë rinumërimit të kutive të votimit, sipas komunave

Në nivel subjektesh politike, devijimet në vota preferenciale kanë prekur kryesisht partitë më të mëdha, për shkak të volumit më të lartë të votave që ato administrojnë. Partia Demokratike e Kosovës rezulton me bilancin neto më të lartë negativ (-12,957), e ndjekur nga Lëvizja Vetëvendosje (-4,011), Lidhja Demokratike e Kosovës (-2,692) dhe AAK (-2,302). Ndryshimet kanë ndikuar në renditjen e kandidatëve brenda listave, por jo në balancën e përgjithshme të mandateve ndërmjet subjekteve politike.

Kandidatët nga radhët e subjektet politike	Diferenca (neto)
130. PARTIA DEMOKRATIKE E KOSOVËS – PDK	-12957
116. Lëvizja VETËVENDOSJE!	-4011
123. LIDHJA DEMOKRATIKE E KOSOVËS – LDK	-2692
129. AAK - ALEANCA PËR ARDHMËRINË E KOSOVËS	-2302
127. SRPSKA LISTA	-139
132. KOALICIJA VAKAT	-139
133. PARTIA ROME E BASHKUAR E KOSOVËS	-53
111. NOVA DEMOKRATSKA STRANKA	-48
119. Nedžmidin Sejdilar	-1
126. SOCIJALDEMOKRATSKA UNIJA – SDU	24
118. JEDINSTVENA GORANSKA PARTIJA	37
120. PARTIA LIBERALE EGJIPTIANE	48
121. KOSOVSKI SAVEZ	75
112. KOSOVA DEMOKRATİK TÜRK PARTİSİ – KDTP	76
124. Kosovaki Nevi Romani Partia	94
131. PSA	138
125. PAI-PDAK-LPB	153
134. Za Slobodu Pravdu i Opstanak	184
128. INICIATIVA E RE DEMOKRATIKE E KOSOVËS	187
117. Iniciativa Qytetare Për Kosovë	216
114. FJALA	225
115. Lëvizja Përparimtare e Romëve të Kosovës	330
113. PARTIA BALLI KOMBËTAR DEMOKRAT SHQIPTAR	377
122. NISMA SOCIALDEMOKRATE - NISMA	608

Tabela: Diferenca neto e votave të kandidatëve të subjekteve politike, bazuar në dallimet e kandidatëve brenda secilës listë, pas rinumërimit të kutive të votimit

Megjithatë, një pasojë konkrete e procesit ishte ndryshimi i përfaqësimit brenda listës së KDTP-së, ku kandidati Fikrim Damka u zëvendësua nga Ergül Mazrek pas korrigjimit të preferencave. Ky rast demonstroi se ndryshimet në votat preferenciale nuk kanë qenë vetëm statistike, por kanë pasur efekt të drejtpërdrejtë institucional.

Rinumërimet nuk prodhuan tensione të mëdha në terren dhe u zhvilluan me prani të rregullt të vëzhguesve të partive politike, organizatave dhe mediave. Transparenca e procedurave dhe qasja e vazhdueshme në të dhëna ndihmuan në ruajtjen e stabilitetit të procesit, pavarësisht volumit të lartë të korrigjimeve.

Ky zhvillim ka implikime të rëndësishme institucionale. Integriteti i një procesi zgjedhor nuk matet vetëm nga aftësia për të korrigjuar gabimet, por nga kapaciteti për t'i minimizuar ato në fazën e parë. Mekanizmi korrektues (rinumërimi i plotë) funksionoi dhe e çoi procesin drejt rezultateve përfundimtare më 31 janar, por vetë nevoja për një volum kaq të madh korrigjimesh e bën të qartë se pika më e dobët e administrimit zgjedhor mbetet menaxhimi i votës preferenciale.

Në tërësi, faza paszgjedhore përfundoi me rezultate të konsoliduara dhe të verifikuara, pa krizë legjitimiteti dhe pa tensione të mëdha institucionale. Megjithatë, shkalla e korrigjimeve të nevojshme e bën të qartë se përmirësimi i administrimit të votës preferenciale mbetet një nga prioritetet kryesore për ciklet e ardhshme zgjedhore.

9. DREJTËSIA ZGJEDHORE

Korniza ligjore e Kosovës për drejtësinë zgjedhore parasheh rregulla të detajuara, udhëzime procedurale dhe afate të përshejtuara për parashtrimin dhe shqyrtimin e ankesave në të gjitha fazat e procesit zgjedhor. Palët e interesuara kanë të drejtë të kontestojnë përfshirjen ose përjashtimin nga lista e votuesve, certifikimin e subjekteve politike dhe kandidatëve, shkeljet gjatë fushatës, parregullsitë në ditën e votimit dhe numërimin, si dhe rezultatet përfundimtare të shpallura nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ). Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP) përbën instancën qendrore për trajtimin e kontesteve zgjedhore dhe ka kompetencë të plotë për të shqyrtuar ankesat kundër vendimeve të KQZ-së dhe shkeljeve të rregullave zgjedhore. Vendimet e PZAP-it janë të apelueshme në Gjykatën Supreme në rastet kur përfshijnë gjoba mbi pragun ligjor ose kur prekin të drejta themelore zgjedhore. Si organ i përhershëm dhe i pavarur, i emëruar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, PZAP funksionon si mekanizëm i specializuar gjyqësor për mbrojtjen e integritetit të procesit zgjedhor dhe për garantimin e zgjidhjes së shpejtë të kontesteve.

Në zgjedhjet e parakohshme parlamentare të 28 dhjetorit 2025, drejtësia zgjedhore u karakterizua nga një volum relativisht i kufizuar ankesash dhe nga mungesa e kontesteve të që do të rrezikonin stabilitetin institucional të procesit. Kjo paraqet një dallim të dukshëm nga disa cikle të mëparshme, ku drejtësia zgjedhore ishte shndërruar në arenë për përplasje të forta politike. Në këtë cikël, kontestet mbetën kryesisht të natyrës administrative dhe disiplinore, pa tentativë sistematike për të delegjitimuar procesin përmes mekanizmave juridikë.

Që nga shpallja e zgjedhjeve parlamentare të 28 dhjetorit 2025 e deri në shpalljen e rezultateve përfundimtare, Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa ka pranuar dhe shqyrtuar gjithsej 80 ankesa. Pjesa më e madhe e tyre lidhej me vendimet fillestare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, përfshirë emërimin

proporcional të anëtarëve të Komisioneve Komunale Zgjedhore, certifikimin e subjekteve politike dhe kandidatëve, akreditimin e vëzhguesve të organizatave joqeveritare, miratimin e qendrave dhe vendvotimeve jashtë Kosovës, si dhe dizajnin e fletëvotimeve.

Në fazën e fushatës dhe paszgjedhore, PZAP ka shqyrtuar gjithashtu ankesa që lidhen me shkeljen e rregullave të fushatës zgjedhore, kontestimet mbi numërimin e votave preferenciale në Qendrat Komunale të Numërimin, si dhe ankesa kundër vendimit përfundimtar për shpalljen e rezultateve të zgjedhjeve.

Gjatë periudhës së fushatës zgjedhore, që u zhvillua nga 17 deri më 28 dhjetor 2025, në PZAP u parashtruan gjithsej 25 ankesa për shkelje të rregullave zgjedhore. Nga këto, PZAP nxori 16 vendime, prej të cilave shtatë ishin vendime dënuese, tetë ishin vendime refuzuese dhe një rast ishte tërheqje e ankesës. Profili i këtyre ankesave tregon se drejtësia zgjedhore u përdor si mekanizëm selektiv për adresimin e shkeljeve konkrete. Shumica e ankesave lidhej me vendosjen e materialeve zgjedhore në hapësira të ndaluara, përdorimin e resurseve publike për qëllime elektorale dhe përfshirjen e fëmijëve në aktivitete politike.

Në aspektin e diskursit politik, një element me rëndësi për drejtësinë zgjedhore është mungesa e ankesave për gjuhë nxitëse apo të urrejtjes. Ky fakt përbën zhvillim pozitiv krahasuar me ciklet e mëparshme, ku një pjesë e konsiderueshme e gjobave lidhej pikërisht me këtë kategori shkeljesh. Edhe pse mungesa e ankesave nuk përjashton ekzistencën e incidenteve sporadike, ajo tregon një nivel më të lartë vetëpërmbytjeje nga subjektet politike dhe një normalizim gradual të diskursit publik. Në fazën e fushatës nuk u evidentua një valë e re ankesash në Gjykatën Supreme që do të tregonte për një zinxhir të zgjatur kontestimi.

Sa i përket sanksioneve për shkelje të rregullave të fushatës, PZAP shqiptoi gjithsej 159,500 euro gjoba. Pjesa

më e madhe e këtyre sanksioneve i takon Listës Serbe, e cila u gjobit me 147,000 euro përmes pesë vendimeve që lidhen kryesisht me vendosjen e materialeve zgjedhore në hapësira publike. Lëvizja Vetëvendosje u gjobit me gjithsej 10,500 euro në dy vendime të ndara: 6,000 euro për përdorim të resurseve publike dhe shfrytëzim të pozitës zyrtare për përfitim elektoral, si dhe 4,500 euro për përdorim të fëmijëve në fushatë zgjedhore. Partia Liberale Egjiptiane u gjobit me 2,000 euro për cenim të fshehtësisë së votës në diasporë. Struktura e sanksioneve tregon se ndërhyrja ndëshkuese e PZAP-it u përqendrua kryesisht në shkeljet e dukshme dhe të përsëritura, veçanërisht ato që lidhen me përdorimin e hapësirave publike dhe keqpërdorimin e resurseve zyrtare gjatë fushatës.

Subjekti Politik	Gjobat (€)
Lista Serbe	147,000
Lëvizja Vetëvendosje	10,500
Partia Liberale Egjiptiane	2,000

Analiza e vendimeve nxjerr në pah një problem të përsëritur të drejtësisë zgjedhore në Kosovë, me theks tek mungesa e konsistencës në shqiptimin e sanksioneve për shkelje të ngjashme. Në disa raste, gjobat për vendosjen e materialeve në hapësira publike kanë variuar ndjeshëm, pa një standard të qartë proporcionaliteti. Një drejtësi zgjedhore efektive nuk matet vetëm nga numri i gjobave, por nga koherenca e arsyetimit dhe barazia në trajtimin e subjekteve.

Analiza e vendimeve të PZAP për shkeljet gjatë fushatës zgjedhore

Gjatë shqyrtimit të vendimeve të PZAP lidhur me shkeljet e rregullave të fushatës zgjedhore për zgjedhjet e 28 dhjetorit 2025, janë evidentuar disa diskrepanca në mënyrën e shqiptimit të dënimeve ndaj subjekteve politike që kanë cenuar rregullat e fushatës. Në pesë raste të vendosura me shqiptim gjobe për vendosje të materialeve zgjedhore në hapësira publike, vërehet se lartësia e gjobës nuk ka qenë konsistente dhe jo gjith-

monë në përputhje me peshën e shkeljes.

Në rastin A.nr.25/25, PZAP shqiptoi gjobë prej 20 mijë euro ndaj subjektit politik Lista Serbe për vendosjen e materialit zgjedhor në hapësira të ndaluara publike, ndërsa në rastin A.nr.26/25, për shkelje të ngjashme, i njëjti subjekt u gjobit me 2 mijë euro. Ngjashëm, në vendimin A.nr.32/25 u shqiptua gjobë prej 30 mijë euro, në vendimin A.nr.34/25 gjobë prej 50 mijë euro, dhe në vendimin A.nr.46/25 gjobë prej 45 mijë euro për shkelje të së njëjtës natyrë.

Në rastet kur një subjekt politik është përsëritës në kryerjen e shkeljeve të rregullave të fushatës, sistemi ndëshkues duhet të reflektojë qartë progresionin e sanksioneve, në mënyrë që të garantohet proporcionalitet dhe efekt parandalues.

Kjo tregon mungesën e konsistencës në vendimet e PZAP, duke lënë hapësirë për interpretime të ndryshme nga panelet e tij. Prandaj, kjo lloj mënyre e vendosjes në të ardhmen duhet të shqyrtohet e analizohet më kujdesshëm dhe substancialisht nga ana e Paneleve të PZAP-së, për faktin se kur një subjekt politik është përsëritës në kryerjen e një shkelje të rregullave të fushatës, vendimet me gjobë nuk duhet të variojnë nga më e larta tek e ulëta, por krejtësisht e kundërta.

Në fund, vlen të theksohet se gjatë fushatës zgjedhore për zgjedhjet e parakohshme parlamentare të 28 dhjetorit 2025 nuk pati asnjë ankesë dhe asnjë vendim nga PZAP lidhur me përdorimin e gjuhës nxitëse dhe urrejtëse. Kjo sugjeron një diskurs politik më të moderuar krahasuar me ciklet e mëparshme zgjed-

hore. Megjithatë, mungesa e ankesave nuk përjash-ton domosdoshmërisht ekzistencën e shkeljeve nën pragun e denoncimit formal, prandaj ky zhvillim duhet vlerësuar me kujdes.

Trajtimi i vendimeve të PZAP-së në Gjykatë Supreme

Të dhënat e monitoruara nga platforma e sistemit gjyqësor për publikimin e aktgjykimeve tregojnë se vetëm në një rast vendimet e PZAP janë kundërshtuar në Gjykatën Supreme në lidhje me gjobat e shqiptuara për shkelje të rregullave të fushatës zgjedhore. Subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje kishte kontestuar vendimin e PZAP A.nr.41/2025 të datës 26.12.2025, me të cilin ishte gjobitur me 6,000 euro për përdorim të resurseve publike, duke pretenduar se vendimi ishte marrë në kundërshtim me ligjin dhe nenin 36 të LZP-së.

Gjykata Supreme, me aktgjykimin AA.nr.134/2025 të datës 31 dhjetor 2025, e refuzoi si të pathemeltë ank-esën e Lëvizjes Vetëvendosje, duke vlerësuar se ven-dimi i PZAP ishte i bazuar në prova konkrete dhe të mjaftueshme.¹ Sipas arsytimit të Gjykatës Supreme, nga verifikimi i provave – përfshirë materialet e pub-likuara në rrjete sociale – rezultonte se kandidatët e subjektit politik ankues (Arbërie Nagavci, Hysen Durmi-shi, Arben Vitia, Albulena Haxhiu dhe Hajrulla Çeko) kishin promovuar aktivitetet e tyre gjatë fushatës zgjed-hore në hapësira publike institucionale – përkatësisht në: Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Qendrën Klinike Universitare të Kosovës, Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës si dhe Urën në Mitrovicë – duke përdorur simbolet dhe identifikimin zgjedhor të subjektit politik.

Ankesat për shkeljet ligjore gjatë ditës së zgjedhjeve

Gjatë ditës së zgjedhjeve, në PZAP janë parashtruar gjithsej nëntë ankesa lidhur me shkeljen e heshtjes zgjedhore. Nga këto raste, shtatë ankesa janë refuzuar si të pabazuara, ndërsa në dy raste PZAP ka shqiptuar

gjoba ndaj subjekteve politike për shkelje të heshtjes zgjedhore.

Me vendimin A.nr.53/2025 të datës 30 dhjetor 2025, PZAP shqiptoi gjobë prej 1,000 euro ndaj subjektit politik AAK, pasi kandidati për deputet i këtij subjekti, Gazmend Syla, kishte publikuar në ditën e zgjedhjeve një fotografi në rrjetet sociale, të shoqëruar me thirrje për votim gjatë ditës së zgjedhjeve.²

Po ashtu, me vendimin A.nr.56/2025, PZAP shqiptoi gjobë prej 1,000 euro ndaj subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje për shkelje të heshtjes zgjedhore, pasi zyrtarja e këtij subjekti, njëherësh këshilltare e kuvendit komunal në Rahovec, Vlora Vuçitërna, kishte publikuar në rrjetin social Facebook një fotografi gjatë procesit të votimit, të shoqëruar me mesazhin politik “Unë nuk lëshoj pe!”.³

Ankesat gjatë procedurës së numërimit në QKN dhe QNR

Gjatë procesit të numërimit të votave të kandidatëve për deputet në Qendrat Komunale të Numërimit (QKN), për zgjedhjet parlamentare të 28 dhjetorit 2025, në PZAP janë parashtruar rreth dhjetë ankesa lidhur me administrimin e këtij procesi. Shumica dërrmuese e këtyre ankesave janë refuzuar nga PZAP si të paba-zuara, ndërsa disa janë refuzuar si të paraqitura jashtë afatit ligjor.

Ndër rastet më të rëndësishme gjatë kësaj faze ishin ankesat e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës dhe të kandidatit të saj Bekim Haxhiu, të cilat kishin të bënin me pranueshmërinë dhe vlefshmërinë e votave të ardhura me postë nga diaspora. Ankuesit pretendonin se, në bazë të nenit 96 të Ligjit për Zgjedhjet e Përg-jithshme, afati i fundit për pranimin e fletëvotimeve me postë ishte data 29 dhjetor 2025, ora 16:00 – me kusht që të ketë vulën e dërgimit para ditës së zgjedhjeve, dhe se ligji nuk parashihte asnjë përjashtim apo autorizim për zgjatje të këtij afati nga organet administrative.

² PZAP, vendim në rastin A.nr.53/2025, date 30 dhjetor 2025. I qasshëm në linkun: <https://smaa.rks-gov.net/documents/51552.pdf>

³ PZAP vendim në rastin A.nr.56/25 datë 30 dhjetor 2025. I qasshëm në linkun: <https://smaa.rks-gov.net/documents/51550.pdf>

¹ Gjykata Supreme e Kosovës, vendim në rastin AA.Nr.134/25, date 31 dhjetor 2025. I qasshëm në linkun: https://supreme.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/verdicts/SUP_AA%20_134_2025_SQ.pdf

PZAP, gjatë shqyrtimit të këtyre ankesave, konstatoi se ato ishin paraqitur pas afatit ligjor prej 48 orësh nga ndodhja e shkeljes së supozuar, siç përcaktohet me nenin 119 të ligjit përkatës. Duke qenë se pretendi-met e ankuesve ndërlidheshin me pranimin e fletëvo-timeve në datat 2 dhe 5 janar 2026, ndërsa ankesat ishin dorëzuar më 8 janar 2026, paneli vlerësoi se afati procedural ishte tejkaluar dhe, për rrjedhojë, i refuzoi ato si të pasafatshme.⁴

Ndaj këtij vendimi të PZAP-it, subjekti politik PDK kishte parashtruar ankesë edhe në **Gjykatën Supreme të Kosovës**, e cila e refuzoi atë si të pabazuar. Gjykata Supreme vlerësoi se qëndrimet e PZAP-it të shprehura në vendimin nr. A.69/2025 ishin të drejta dhe të bazuara në ligj, duke e konsideruar të pabazuar kërkesën për përjashtimin dhe anulimin e fletëvotimeve të ardhura me postë pas datës 29 dhjetor 2025, si dhe atyre të pranuar më 2 dhe 5 janar 2026.⁵

Në arsyetimin e saj, Gjykata Supreme theksoi se nga përmbajtja e ankesës rezultoi qartë që ankuesi kon-testonte pranimin e fletëvotimeve me postë për shkak të afatit, dhe në asnjë pjesë nuk i referohej parregullsive në numërim, në mënyrë që afati procedural të lidhej me datën e pretenduar të parregullsive, siç kërkohet me ligj për paraqitjen e ankesës. Sipas Gjykatës, pakënaqësitë eventuale të subjekteve politike nuk mund të shërbe-jnë si bazë për mohimin e të drejtës së votimit apo të numërimit të votave të pranuar më 2 dhe 5 janar 2026.

⁴ Shih dy vendimet e PZAP në rastet A.nr.69/2025 datë 9 janar 2025, I qasur në linkun: [https://smaa.rks-gov.net/docu-ments/51754.pdf](https://smaa.rks-gov.net/documents/51754.pdf) dhe vendimin A.nr.73/2026 datë 12 janar 2025. I qasshëm në linkun: <https://smaa.rks-gov.net/documents/51778.pdf>

⁵ Shih, Gjykata Supreme e Kosovës, vendim në rastin A.nr.4/2026 datë 14 janar 2026. I qasshëm në linkun: https://supreme.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/verdicts/SUP_AA%20_4_2026_SQ.pdf

Ankesat pas shpalljes së rezultateve përfundimtare

Më 31 janar 2026, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve shpalli rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve. Ky vendim u shoqërua me kontestime procedurale në dy aspekte. Së pari, KQZ nuk respektoi afatin ligjor prej 48 orësh për paraqitjen e ankesave lidhur me procesin e rinumërimit në QNR. Së dyti, KQZ vendosi të ndajë procedurën e shpalljes së rezultateve, duke mos votuar rezultatet për të gjitha subjektet politike bashkërisht, por duke parcializuar procesin e votimit për rezultatin zgjedhor të subjektit politik Lista Serbe – që rezultoi me mosvotim të shpalljes së rezultateve për këtë subjekt, duke mos duke krijuar pasiguri procedurale në inter-pretimin e rregullave.

Pas këtij vendimi, në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia u parashtruan gjithsej shtatë ankesa. Gjashtë prej tyre u refuzuan si të pabazuara, ndërsa një ankesë u aprovua.

Në këtë fazë, PZAP aprovoi ankesën e subjektit politik Lista Serbe dhe ndryshoi vendimin e KQZ-së lidhur me mos shpalljen e rezultateve për këtë subjekt. Me vendimin e tij, PZAP konstatoi se rezultati përfundimtar për subjektin Lista Serbe dhe kandidatët e saj duhej të shpallej njëkohësisht me rezultatet e subjekteve të tjera zgjedhore.⁶ Në arsyetimin e vendimit, PZAP theksoi se nuk pajtohet me vendimin e KQZ-së për mos shpalljen e rezultatit për këtë subjekt, duke vlerësuar se një veprim i tillë ishte i pajustificuar dhe në kundërshtim me dis-pozitat përkatëse ligjore. Sipas PZAP-së, duke qenë se të gjitha procedurat e numërimit dhe rinumërimit kishin përfunduar për të gjitha subjektet politike, rezultati për-fundimtar duhej të shpallej menjëherë dhe në mënyrë të plotë, pa përjashtime.

Paneli vlerësoi se shpallja e pjesshme e rezultateve krijon pasiguri juridike dhe bie ndesh me parimet e barazisë së subjekteve zgjedhore, transparencës dhe sigurisë së procesit zgjedhor. Në këtë kuadër, PZAP konsideroi se qasja e ndjekur nga KQZ nuk ishte në për-puthje me standardet e praktikës së mirë zgjedhore, siç reflektohen edhe në parimet e Komisionit të Venecias.

⁶ PZAP vendim nr.A.80/2026, datë 3 shkurt 2026, I qa-sshëm në linkun: <https://smaa.rks-gov.net/documents/51822.pdf>

Dy ankesa të tjera u parashtruan nga kandidati për deputet Bekim Haxhiu, i cili kërkonte anulimin e votave me postë si dhe korrigjimin e ndarjes së mandateve sipas kuotës gjinore, duke pretenduar se KQZ nuk kishte bërë llogaritje të drejtë të mandateve.

Dy ankesa të tjera u parashtruan nga subjekti politik Nova Demokratska Stranka, prej të cilave, njëra lidhur me pretendimet për parregullsi në marrjen e votave nga Koalicioni Vakati në vendvotime ku nuk ka përqendrim demografik të komunitetit boshnjak, dhe tjetra lidhur me pretendimin se subjekti politik Za Slobodu Pravdu i Opstanak kishte fituar vota në mënyrë të parregullt në zona ku nuk ka anëtarë të komunitetit serb, si dhe dyshime në përllogaritjen e votave.

Një ankesë u parashtrua nga Koalicioni PAI-PDAK-LPB, i cili pretendoi se KQZ kishte shmangur disa procedura gjatë numërimit dhe rinumërimit të votave, duke kërkuar rinumërim shtesë për subjektet e komuniteteve Ashkali dhe Egjiptian, anulim të votave në vendbanime ku nuk ka pjesëtarë të këtyre komuniteteve sipas të dhënave të regjistrimit të fundit të popullsisë, si dhe përsëritje të zgjedhjeve në komunat përkatëse.

Një tjetër ankesë u parashtrua nga Partia Rome e Bashkuar e Kosovës, e cila pretendoi mospërputhje të theksuara në shpërndarjen territoriale të votave të një subjekti tjetër rom, duke ngritur dyshime mbi natyrën e votimit në disa komuna.

Pas shqyrtimit të këtyre gjashtë rasteve, PZAP nxori gjashtë vendime përmes të cilave konstatoi se ankesat ishin të pabazuara dhe të paqëndrueshme, duke vlerësuar se procedurat e numërimit, rinumërimit dhe ndarjes së mandateve nga ana e KQZ-së kishin qenë në përputhje me kornizën ligjore.⁷

⁷ Shih vendimet refuzuese të PZAP në rastet: A.nr.75/2026 deri në A.nr.79/2026 të qasshëm në linkun: <https://pzap.rks-gov.net/results/>

Ankesat e palëve në Gjykatën Supreme dhe vendimet e saj

Më 9 shkurt 2026, Gjykata Supreme e Kosovës shqyrtoi gjashtë ankesa administrative të paraqitura kundër vendimeve të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parash-tresa (PZAP), duke i refuzuar të gjitha si të pabazuara dhe duke konfirmuar ligjshmërinë e vendimmarrjes së këtij institucioni. Vendimet e Supremes përbëjnë një vazhdimësi të qartë të qasjes restriktive ndaj ndërhyrjeve në rezultat zgjedhor, duke vendosur një standard të lartë provues për çdo pretendim që synon anulimin e votave.

Me aktgjykimin AA.nr.6/2026, Gjykata refuzoi ankesën e Partisë Rome e Bashkuar e Kosovës (PREBK), duke pranuar në tërësi arsyetimin juridik të PZAP. Gjykata vlerësoi se pretendimi se votat ishin në disproporcion me përbërjen demografike të komunitetit rom nuk përbënte bazë për anulim. Ky interpretim riafirmon parimin se vota është individuale dhe nuk lidhet juridikisht me identitetin etnik të votuesit.⁸

Në mënyrë të ngjashme, me aktgjykimin AA.nr.7/2026, Gjykata refuzoi ankesën e Koalicionit PAI-PDAK-LPB, duke konstatuar se ankuesi nuk kishte paraqitur asnjë provë konkrete për të mbështetur pretendimet për manipulime ose parregullsi në procesin e votimit. Gjykata theksoi se kontestimi i rezultatit zgjedhor kërkon bazë faktike të verifikueshme dhe jo vetëm dyshime ose pretendime të përgjithshme.

Me aktgjykimin A.A.nr.8/2026, Gjykata refuzoi ankesën e Emilija Rexhepit nga Nova Demokratska Stranka (NDS), e cila kishte kërkuar anulimin e 85 votave në një vendvotim të caktuar dhe korrigjimin e rezultatit për mandatin e rezervuar për komunitetin boshnjak. Gjykata vlerësoi se anulimi i votave përbën masë të jashtëzakonshme që mund të justifikohet vetëm në rast të shkeljeve të provuara qartë dhe me ndikim të drejtpërdrejtë në rezultat. Pranimi i pretendimeve të pam-bështetura do të krijonte precedent të rrezikshëm për sigurinë juridike dhe stabilitetin e procesit zgjedhor.⁹

⁸ Shih:Gjykata Supreme e Kosovës vendim në rastin AA.nr.7/2026, date 9 shkurt 2026, I qasshëm në linkun: <https://supreme.gjyqesori-rks.org/publikimet/aktgjykimet/>

⁹ Po aty, vendim në rastin A.A.nr.8/2026, I qasshëm në linkun: <https://supreme.gjyqesori-rks.org/publikimet/aktgjykimet/>

Këtë linjë arsyetimi Gjykata e zhvilloi më tej në aktgjykimin A.A.nr.9/2026, duke refuzuar një tjetër ankesë të NDS. Supremja theksoi se ligji zgjedhor nuk kushtëzon vlefshmërinë e votës me përkatësinë etnike të votuesit. Vota konsiderohet e vlefshme për sa kohë është ush-truar nga një qytetar i regjistruar ligjërisht dhe në për-puthje me procedurat zgjedhore. Sipas Gjykatës, vetëm shkeljet konkrete dhe të rënda që cenojnë integritetin e procesit mund të justifikojnë ndërhyrje në rezultat, ndërsa argumentet mbi përbërjen etnike të votuesve nuk përbëjnë bazë kushtetuese apo ndërkombëtare për anulim votash.¹⁰

Me aktgjykimin AA.nr.10/2026, Gjykata refuzoi ankesën e kandidatit të PDK-së, Bekim Haxhiu, lidhur me ndarjen e mandateve sipas kuotës gjinore. Gjykata konfirmoi se sistemi zgjedhor kërkon jo vetëm përfaqësim formal gjinor në listat e kandidatëve, por edhe reflektim real të këtij parimi në shpërndarjen përfundimtare të man-dateve. Vendimi riafirmoi interpretimin se kuota gjinore është element strukturor i sistemit zgjedhor dhe jo vetëm kriter procedural.¹¹

Në aktgjykimin A.A.nr.11/2026, Gjykata refuzoi edhe ankesën e dytë të të njëjtit kandidat lidhur me anulimin e votave me postë, që pretendonte që kishin ardhur pas afatit ligjor. Supremja vlerësoi se pranimi i këtyre votave ishte bazuar në një vendim të vlefshëm të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, i cili kishte prodhuar efekte juridike të plota dhe nuk ishte kontestuar brenda afat-eve ligjore. Gjykata theksoi se mosushtrimi i mjeteve juridike kundër një vendimi administrativ nënkupton pranimin e tij dhe konsolidimin e fuqisë së tij juridike. Përpjekjet e mëvonshme për të kontestuar pasojat e një vendimi të tillë, pa e sfiduar vetë vendimin në kohë, bien ndesh me parimet e sigurisë juridike dhe besimit të ligjshëm në veprimet e autoriteteve publike.¹²

¹⁰ Gjykata Supreme e Kosovës, vendim në rastin A.A.nr.9/2026, date 9 shkurt 2026, I qasshëm në linkun: <https://supreme.gjyqesori-rks.org/publikimet/aktgjykimet/>

¹¹ Po aty, Gjykata Supreme e Kosovës, vendim në rastin A.A.10/2026, date 9 shkurt 2026. I qasshëm në linkun: <https://supreme.gjyqesori-rks.org/publikimet/aktgjykimet/>

¹² Gjykata Supreme e Kosovës, vendim në rastin A.A.11/2026, date 9 shkurt 2026. I qasshëm në linkun: <https://supreme.gjyqesori-rks.org/publikimet/aktgjykimet/>

Në tërësi, vendimet e Gjykatës Supreme gjatë kësaj periudhe paszgjedhore konfirmojnë një qasje të qëndrueshme të jurisprudencës zgjedhore, që mbrojnë stabilitetin e rezultatit zgjedhor dhe vendos standard të lartë për ndërhyrje gjyqësore. Gjykata privilegjoj sigurinë juridike, proporcionalitetin dhe mbrojtjen e integritetit të votës, duke e kufizuar anulimin e votave vetëm në raste të provuara qartë dhe me ndikim të drejtpërdrejtë në rezultat.

REKOMANDIMET

Duke u bazuar në të gjeturat dhe vlerësimet e dhëna në kuadër të këtij raporti, por edhe zhvillimeve të përgjithshme lidhur me procesin zgjedhor, Demokracia në Veprim ofron një sërë rekomandimesh të cilat synojnë përmirësimin e aspekteve teknike të zgjedhjeve, por edhe sistemin zgjedhor në përgjithësi.

Këto rekomandime, kanë për qëllim iniciimin e një **reforme zgjedhore përmbajtësore**, e cila duhet të përkthehet në ndryshime të kuadrit ligjor për zgjedhje, që adresojnë natyrën teknike të organizimit dhe administrimit të zgjedhjeve, por edhe elemente tjera politike të sistemit zgjedhor. DnV-ja vlerëson që reforma zgjedhore duhet të jetë një nga prioritetet kyçe të spektrit politik duke u bazuar në parimet e gjithëpërfshirjes dhe transparencës.

Paraprakisht, Demokracia në Veprim konsideron se **prioritet** duhet t’u jepet këtyre reformave:

- Reformimit rrënjësor të modelit të numërimit të votave preferenciale të kandidatëve, përfshirë decentralizimin e numërimit dhe përdorimin e teknologjisë për skanim dhe tabulim elektronik.
- Depolitizimit gradual të administrimit zgjedhor, përmes ndarjes së qartë ndërmjet vendimarrjes politike dhe operacioneve teknike në kuadër të KQZ-së.
- Vendorsjes së mekanizmave sistematikë të kontrollit të cilësisë, përfshirë rinumërimin e detyrueshëm në një përqindje të caktuar, auditimin paszgjedhor dhe publikimin e të dhënave të detajuara mbi mospërputhjet.
- Rregullimit të aktiviteteve zgjedhore jashtë periudhës formale të fushatës, si dhe kufizimit të vendimeve ekzekutive me ndikim financiar të drejtpërdrejtë në periudhën parazgjedhore.
- Forcimit të transparencës së financimit dhe fushatës digjitale, përfshirë krijimin e arkivave pub-

like të reklamave online, raportimin e detajuar të shpenzimeve si dhe rregullimin e çështjes së fushatave nga palët e treta.

- Riorganizimit të votimit jashtë vendit përmes qartësimit të bazës ligjore, krijimit të një njësie të përhershme brenda KQZ-së dhe auditimit sistematik pas çdo procesi.
- Sigurimit të koherencës në drejtësinë zgjedhore, përmes standardizimit të sanksioneve dhe harmonizimit të praktikës ndërmjet PZAP-it dhe Gjykatës Supreme, si dhe – në perspektivë – transferimit të kompetencave në Gjykatën Administrative.

Ndërsa, **rekomandimet e plota** në pjesën e mëposhtme, duhet të adresohen nga aktërë të ndryshëm, duke filluar nga ligjvënësit, trupat përgjegjëse për organizimin dhe administrimin e zgjedhjeve, subjektet politike dhe kandidatët e tyre, institucionet përkatëse të sigurisë dhe drejtësisë, shoqëria civile, si dhe institucionet tjera në fushëveprimin e të cilave bie përgjegjësia për ndonjë prej operacioneve zgjedhore.

I. Reforma strukturore e sistemit zgjedhor

Demokracia në Veprim konsideron se është e domosdoshme që, përveç aspekteve teknike të përmirësimit të organizimit dhe administrimit zgjedhor, reforma zgjedhore të përfshijë edhe çështje përmbajtësore, që janë në thelb politike, e të cilat kërkojnë ndryshime kushtetuese dhe ligjore. Ndër elementet e sistemit zgjedhor, të cilat janë duke prodhuar probleme sidomos në përfaqësimin e drejtë qytetar, por dhe funksionalitetin institucional të Kosovës, që DnV vlerëson se duhet të jenë medoemos subjekt i reformës zgjedhore, janë:

- **Votimi preferencial** deri në dhjetë kandidatë, duhet të reduktohet ndjeshëm;
- **Pragu zgjedhor**, përkatësisht aplikimi i tij për subjekte të ndryshme politike si partitë politike, koalicionet dhe kandidatët e pavarur, duhet të rikategorizohet;

- Mënyra së **zgjedhjes së Presidentit** të vendit, duhet të rishqyrtohet;
- Të konsiderohet ndarja në **zona zgjedhore**;
- Të rishikohet modeli i numërimit të votave preferenciale, duke konsideruar **eliminimin e Qendrave Komunale të Numërimit** dhe rikthimin drejt sistemit të decentralizuar të numërimit në vendvotime, të mbështetur me teknologji për skanim dhe numërim elektronik.

II. Korniza e përgjithshme ligjore dhe modeli institucional

- Të **hartohet një kod i unifikuar zgjedhor që konsolidon të gjitha dispozitat rregullative në një dokument të vetëm**.
- Praktika e kodifikimit është e rekomanduar nga OSBE/ODIHR dhe Komisioni i Venecias për të siguruar qartësi ligjore dhe siguri juridike.
- Çështjet që prekin drejtpërdrejt të drejtat zgjedhore – të tilla si certifikimi i subjekteve dhe kandidatëve, interpretimi i kushteve të përshtatshmërisë juridike apo të drejtat tjera pasive zgjedhore – të **transferohen në kompetencë të Gjykatës Administrative** përmes procedurave të posaçme me afate optimale. Deri në realizimin e këtij ndryshimi, të **forcohen kapacitetet e PZAP-it** në periudhat zgjedhore.
- Të **rishikohet përbërja dhe modeli institucional i KQZ-së me qëllim depolitizimin gradual dhe forcimin e rolit profesional e gjyqësor të administrimit zgjedhor**. Duhet të hapet debat institucional për modele alternative të organizimit të administratës zgjedhore, përfshirë mundësinë e një strukture më fleksibile që aktivizohet kryesisht në periudhë zgjedhore, me një përbërje ku rolin dominues e kanë profesionistët e pavarur dhe përfaqësues të sistemit gjyqësor. Një model i tillë duhet të synojë që shumica e anëtarëve të KQZ-së të jenë profesionistë jo-politikë dhe kritere të qarta integriteti.

- Të **avancohen kriteret e përshtatshmërisë juridike**, duke mos lejuar kandidimin e individëve që janë të dënuar për vepra penale të keqpërdorimit të detyrës zyrtare – pavarësisht llojit apo lartësisë së dënimit të shqiptuar.

III. Integriteti dhe administrimi zgjedhor

- Të **përcaktohen në mënyrë më të qartë kufijtë ndërmjet rolit politik të KQZ-së dhe operacioneve teknike të administrimit zgjedhor**, duke garantuar që vendimet operacionale të jenë kompetencë e strukturave profesionale.
- Të **vendosen mekanizma automatikë për rinumërim**. Legjislacioni duhet të parashohë detyrimin për rinumërim të të paktën 5% të vendvotimeve në nivel vendi pas çdo procesi zgjedhor. Ky rinumërim duhet të kryhet në mënyrë automatike, mbi bazë mostre statistikore.
- Të **miratohet një Kod Sjelljeje për anëtarët e KQZ-së, që sanksionon diskursin dhe gjuhën gjatë mbledhjeve të KQZ-së**. Kodi duhet të përfshijë sanksione në rast të shkeljeve – veçanërisht në raport me mundësinë e shkarkimit nga Presidenti i vendit.
- Të **miratohet një akt i veçantë për rekrutimin dhe trajnimin e trupave menaxhuese të zgjedhjeve**, sidomos trupat administruese dhe ekipet e numërimit, duke përfshirë kualifikimet minimale, konfliktet e interesit, standardet për barazi gjinore dhe përfaqësim të komuniteteve, si dhe vlerësimin e performancës.

- Të **krijohet një sistem i strukturuar i kontrollit të cilësisë** gjatë gjithë fazave të procesit zgjedhor, i cili përfshin monitorim të performancës së trupave menaxhuese dhe ekipeve të numërimit, mekanizma të ndërhyrjes së menjëhershme në rast devijimesh dhe vlerësim paszgjedhor të standardizuar të performancës. Ky sistem duhet të përfshijë edhe masa disiplinore për anëtarët e administratës zgjedhore që nuk përmbushin detyrat ose veprojnë me neglizhencë. Në rast të shkeljeve serioze apo performancës së jo të këna-

aqshme, duhet të parashihet kufizimi i përkohshëm ose përjashtimi nga angazhimi në proceset e ard-hshme zgjedhore – sipas modelit të “listave të zeza”.

- **Të përcaktohet me akt normativ detyrimi për hartimin dhe publikimin e një raporti të stan-dardizuar paszgjedhor nga KQZ-ja**, që përfshin vlerësim të plotë të të gjitha fazave të procesit, analizë të mospërputhjeve dhe plan masash për përmirësim.
- Të vendoset një standard i detyrueshëm për **publikimin e të dhënave të detajuara mbi mospër-puthjet, rastet e rinumërimit dhe rezultatin përfundimtar të të gjitha kutive që janë trajtuar në QNR**. Publikimi i këtyre të dhënave duhet të jetë në format të hapur dhe të shoqërohet me shpjegime për secilin rast, në mënyrë që të forcohet transparenca dhe besimi publik.
- **Të standardizohet në mënyrë të detyrueshme interpretimi i rregullave për identifikimin e votuesve**. KQZ duhet të miratojë udhëzime të detajuara dhe të detyrueshme për trajtimin e doku-menteve të skaduara, të cilat të aplikohen njësoj në të gjitha vendvotimet. Trajnimet e komisionerëve duhet të përfshijnë simulime praktike të situatave problematike për të shmangur interpretimet e ndryshme në terren.
- **Të rishikohet përdorimi i ngjyrës matrikuluese**. Çdo mekanizëm identifikimi i votuesit duhet të jetë i certifikuar dhe në përputhje me të drejtat për mbrojtjen e të dhënave personale dhe fshehtësinë e votës. Përdorimi i lapsit matrikulues duhet të rishqyrtohet dhe të kalohet drejt identifikimit elektronik të votuesve.
- KQZ duhet të garantojë **infrastrukturë të për-shtatshme fizike**, për qasje në secilin vendvotim dhe në format e qasshme të votimit **për personat me aftësi të kufizuara**.
- **Të zhvillohet dhe miratohet një Plan Kombëtar i Edukimit Zgjedhor të qytetarëve**, i cili do të zba-tohej vazhdimisht. Plani duhet të jetë gjithëpërf-

shirës, me materiale të standardizuara dhe të përshtatura për grupe të ndryshme të synuara, dhe të zbatohet në bashkëpunim me OShC-të dhe institucionet arsimore.

Lista e Votuesve:

- **Të zhvillohet dhe miratohet një sistem i përher-shëm ndërinstitutional për pastrimin periodik të listës së votuesve, përmes shkëmbimit automa-tik dhe të detyrueshëm të të dhënave ndërmjet KQZ-së, Agjencisë për Regjistrim Civil, Agjencisë së Statistikave, KGJK-së, dhe Departamentit të Pensioneve**. Ky sistem duhet të bazohet në pro-tokolle të dakorduara për identifikimin dhe për-jashtimin e votuesve të ndjerë, personave pa zotësi juridike, dhe atyre me të dhëna të dyfishta. Verifi-kimi duhet të kryhet në mënyrë të përhershme, jo vetëm në prag të zgjedhjeve.
- Të krijohet një **mekanizëm institucional perio-dik për auditimin e Listës së Votuesve**, përmes analizave statistikore dhe krahasuese ndërinstitutionale, me publikim të gjetjeve dhe rekomandime teknike për përditësim të regjistrave, në mënyrë që të forcohet besimi publik dhe koher-enca e të dhënave demografike.
- Të zgjerohet **platforma ekzistuese e-Kosova për të integruar një modul zgjedhor**, përmes të cilit qytetarët të mund të verifikojnë statusin në Listën e Votuesve, të pranojnë njoftime kur të njëjtit ushtro-jnë të drejtën e votimit, (nëse aplikohet) të aplikojnë dhe ndjekin në kohë reale statusin e votimit jashtë vendit, të identifikojnë qendrën e votimit, të marrin njoftime automatike mbi pranimin/refuzimin e kërkesave, si dhe të komunikojnë drejtpërdrejt me administratën zgjedhore.

Votimi jashtë vendit:

- **Të qartësohet përfundimisht baza ligjore për vendndodhjen e qendrave të votimit jashtë vendit**. Ligji duhet të përcaktojë pa hapësirë interpretimi nëse votimi fizik jashtë vendit mund të zhvillohet vetëm në objektet ku janë të vendosura përfaqësitë diplomatike apo edhe në hapësira të tjera.

- **Të rregullohet më tej ndarja e përgjegjësjve institucionale ndërmjet KQZ-së dhe MPJD-së për vendvotimet jashtë vendit**. KQZ-ja duhet të ketë autoritetin e plotë mbi aspektet organizative dhe operacionale të votimit në ambasada, ndërsa MPJD-ja të mbetet vetëm mbështetëse logjistike, siç përcaktohet me ligj dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare.
- **Të krijohet një njësi e veçantë dhe e përhershme brenda KQZ-së që merret me votimin jashtë vendit**. Organizimi i votimit jashtë vendit nuk duhet të improvizohet nga zgjedhja në zgjedhje. Duhet të krijohet një strukturë e përhershme operacionale brenda KQZ-së e specializuar për diasporën, me planifikim shumëvjeçar dhe pro-tokolle standarde.
- **Të zbatohet auditim i pavarur dhe sistematik i të gjithë procesit të votimit jashtë vendit pas çdo palë zgjedhjesh**, përmes një mekanizmi të për-caktuar në legjislacion. Ky auditim duhet të përf-shijë të dhënat e regjistrimit, procedurat postare dhe rrugën e transportit të zarfeve, si dhe të publikohet për të rritur besueshmërinë publike.

IV. Fushata zgjedhore

- **Të ndalohet me ligj shpërndarja e përfitimeve financiare të ekzekutivit për qytetarët brenda një periudhe të përcaktuar para zgjedhjeve**. Duhet të vendoset një moratorium i qartë ligjor për vendime ekzekutive me ndikim financiar të drejtpërdrejtë mbi kategori të caktuara qytetarësh gjatë periudhës që nga shpallja e ditës së zgjedhjeve, përveç rasteve emergjente të justifikuara me ligj.
- **Të rregullohet me legjislacion të qartë periudha e parafushatës zgjedhore, për të parandaluar keqpërdorimin e kësaj faze nga subjektet politike dhe për të garantuar barazi në garë**. Rregullimi duhet të përcaktojë se cilat aktivitete përbëjnë fus-hatë të parakohshme, si dhe standardet për trans-parencë financiare, përdorim të resurseve publike dhe sanksionet në rast të shkeljeve.

- **Të forcohet transparenca dhe mbikëqyrja e financimit të fushatës**, duke detyruar subjektet politike të dorëzojnë raporte të detajuara javore gjatë periudhës së fushatës, përfshirë të gjitha shpenzimet online dhe offline, me publikim të men-jëhershëm në faqet zyrtare të KQZ-së dhe partive politike.
- **Të krijohet praktikë e organizimit të debat-eve publike midis kandidatëve kryesorë**, të organizuara nga mediat (sidomos transmetuesi publik), me pjesëmarrje të barabartë, për të mundësuar qytetarëve krahasim të platformave në mënyrë të informuar.

Financimi i subjekteve politike gjatë fushatës

- Financimi i subjekteve politike, sidomos gjatë peri-udhës së fushatës, duhet të avancohet. **Subjektet politike duhet të hapin llogari të veçanta bankare për financimin dhe shpenzimet e tyre gjatë fus-hatës**, të cilat duhet të jenë transparente dhe të qasshme për publikun, në faqen elektronike të KQZ-së, ndonjë portal tjetër, ose në faqet elektronike të vetë subjektit politik apo kandidatëve.

a) **Alternativë tjetër** mund të jetë **operacional-izimi i plotë i një sistemi elektronik për rapor-timin financiar të fushatës – në baza javore** – i integruar në platformën e KQZ-së, i cili do të mundësonte dorëzimin, shqyrtimin dhe publi-kimin e menjëhershëm të të dhënave nga sub-jektet politike. Platforma duhet të jetë publike dhe e qasshme për monitorim.

- Duhet patjetër të rregullohet çështja e **deklarimit financiar për kandidatët e subjekteve politike**, duke përfshirë të hyrat dhe shpenzimet personale për periudhën gjatë fushatës.
- Të përfshihet në legjislacionin zgjedhor rregullimi i **fushatave nga palët e treta (third-party campaign-ing)**, duke vendosur detyrime për deklarim, trans-parencë të burimeve financiare dhe raportim të shpenzimeve, me qëllim parandalimin e evitimit të kufizimeve ligjore.

- **Të ndahen fonde të veçanta publike për fushatat e kandidateve gra**, duke krijuar një skemë publike financimi, që synon fuqizimin e grave në garën politike dhe reduktimin e pabarazive strukturore financiare.
- Subjektet politike duhet të bëjnë **transparente mënyrën e shpërndarjes së fondeve të tyre për kandidatet gra**, me qëllim që të ketë përkrahje të barabartë për të gjithë kandidatët.

V. Përfaqësimi gjinor

- **Të miratohen ndryshime ligjore që e shndërrojnë kuotën 30% për gratë në listat zgjedhore në një objektiv progresiv drejt përfaqësimit të barabartë (50/50)**, në përputhje me Ligjin për Barazi Gjinore. Ky ndryshim duhet të shoqërohet me dispozita që ndalojnë listat me përfaqësim minimal të përsëritur dhe që nxisin rotacionin gjinor në pozitat e larta në lista.
- **Të zbatohet Ligji për Barazi Gjinore në të gjitha nivelet e administratës zgjedhore**, përfshirë Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, Komisionet Komunale Zgjedhore dhe Këshillat e Vendvotimeve. Ky zbatim duhet të përfshijë detyrimin për përfaqësim të balancuar gjinor në përbërje dhe udhëheqje, me raporte vjetore të monitorimit.

VI. Drejtësia zgjedhore

- **Të rishikohen dhe standardizohen dispozitat mbi gjobat, duke kufizuar diskrecionin dhe duke lidhur sanksionet me kritere të matshme dhe të unifikuara**. PZAP duhet të zbatojë një sistem gradimi të gjobave për çdo lloj shkeljeje, i cili përcakton qartë kufijtë minimalë dhe maksimalë, bazuar në faktorë si përsëritja e shkeljes, ndikimi në publik, përhapja përmes mediave dhe dështimi për të ndërmarrë masa korrigjuese. Rregullorja për sanksionet duhet të jetë publike dhe e azhurnuar, për të shmangur vendimmarrjet arbitrare dhe për të garantuar proporcionalitet.

- **Të harmonizohen standardet e vendimmarrjes ndërmjet PZAP-it dhe Gjykatës Supreme për të siguruar qasje të njëtrajtshme dhe koherente në drejtësinë zgjedhore**. Këshilli Gjyqësor, përmes trajnimeve të përbashkëta dhe analizave krahasuese të praktikës gjyqësore, duhet të kontribuojë në ndërtimin e një jurisprudence të qëndrueshme dhe të parashikueshme, që respekton të drejtën për ankesë, por gjithashtu mbron integritetin e procesit zgjedhor.
- **Të përmirësohet mekanizmi për referimin e rasteve penale në Prokurori nga ana e institucioneve zgjedhore**. PZAP dhe KQZ duhet të kenë një protokoll të qartë bashkëpunimi me Prokurorinë e Shtetit për raportimin e rasteve që përmbajnë elemente të veprave penale. Ky protokoll duhet të përfshijë kritere për identifikimin e dyshimeve, formatin e referimit dhe afatet për veprim institucional.
- **Të hartohet dhe miratohet një katalog i shprehjeve të gjuhës së urrejtjes dhe shprehjeve diskriminuese në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe kushtetuese të lirisë së shprehjes**. Ky katalog do të shërbente si referencë zyrtare për institucionet përgjegjëse, duke ofruar përkufizime të qarta për gjuhën nxitëse, shprehjet e urrejtjes dhe ato që përbëjnë diskriminim ndaj grupeve të cënueshme. Dokumenti duhet të përgatitet në bashkëpunim me institucionet e drejtësisë, përfaqësues të mediave, organizatat e shoqërisë civile dhe ekspertë të të drejtave të njeriut, dhe të miratohet si aneks ose udhëzues zbatues për PZAP-in dhe KQZ-në.
- *(Në rast se nuk realizohet transferimi i kompetencave drejt Gjykatës Administrative) të përforcohet kapaciteti institucional i PZAP-it përmes rritjes së stafit profesional dhe burimeve teknike, në mënyrë që të garantohet trajtim i shpejtë, i njëtrajtshëm dhe i parashikueshëm i ankesave.*

Shtojca 1: Rezultatet e certifikuara të zgjedhjeve dhe ndarja e ulëseve sipas subjekteve politike

Subjekti politik	Numri i votave	Përqindja	Numri i ulëseve
Lëvizja VETËVENDOSJE!	487,077	51,10%	57
PARTIA DEMOKRATIKE E KOSOVËS - PDK	192,434	20,19%	22
LIDHJA DEMOKRATIKE E KOSOVËS - LDK	126,163	13,24%	15
AAK - ALEANCA PËR ARDHMËRINË E KOSOVËS	52,423	5,50%	6
SRPSKA LISTA	42,759	4,49%	9
NISMA SOCIALDEMOKRATE - NISMA	15,189	1,59%	0
KOSOVA DEMOKRATIK TÛRK PARTISI	5,410	0,57%	2
Za Slobodu Pravdu i Opstanak	4,862	0,51%	1
KOALICIJA VAKAT	3,983	0,42%	1
NOVA DEMOKRATSKA STRANKA	3,920	0,41%	1
INICIATIVA E RE DEMOKRATIKE E KOSOVËS	2,768	0,29%	1
SOCIJALDEMOKRATSKA UNIJA – SDU	2,613	0,27%	1
PARTIA LIBERALE EGJIPTIANE	2,252	0,24%	1
PSA	2,059	0,22%	1
JEDINSTVENA GORANSKA PARTIJA	1,547	0,16%	1
Lëvizja Përparimtare e Romëve të Kosovës	1,173	0,12%	1
PARTIA ROME E BASHKUAR E KOSOVËS	929	0,10%	0
PARTIA BALLI KOMBËTAR DEMOKRAT SHQIPTAR	919	0,10%	0
FJALA	904	0,09%	0
Iniciativa Qytetare Për Kosovë	793	0,08%	0
KOSOVSKI SAVEZ	537	0,06%	0
Nedžmidin Sejdilar	268	0,03%	0
Kosovaki Nevi Romani Partia	227	0,02%	0



Demokracia në Veprim
Demokratija na Delu
Democracy in Action

Përkrahur nga:



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

**Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC**



Sweden
Sverige